



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**INSTITUCIONI I PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER**



**RAPORT**

**PËR VEPRIMTARINË E KRYER NGA INSTITUCIONI GJATË VITIT 2016**

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2016

Qellimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2016, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 8927, date 25.07.2002 “Për Prefektin” dhe Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”

**Hartuar nga:** Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

**Adresa:** Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel /faks. 00355 2224 2705, e-mail: [prefekturashkodër@yahoo.com](mailto:prefekturashkodër@yahoo.com)

Shkoder, Janar 2017

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (*Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së shqiptarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike*), në nivel qarku

## Përmbajtja

I.	Hyrje.....	5
II.	Përmbledhje .....	6
III.	Baza Ligjore .....	9
IV.	Realizimi i detyrave dhe prioriteteve, në lidhje me programin e qeverisë.....	10
IV.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave.....	10
IV.2.	Realizimi i Investimeve.....	11
V.	Marrëdhëniet e Prefektit me Administratën e shtetit (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor).....	16
V.1.	Institucionet në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre.....	17
V.2.	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim.....	20
V.3.	Problemet e konstatuar nga analizat mujore të punës së institucioneve qendrore në nivel vendor.....	22
V.4.	Grupet e punës ndërinstitucionale (task-forcat).....	22
V.5.	Masat ndaj antitrafikimit të qënieve njerëzore.....	24
V.6.	Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat.....	25
VI.	Marrëdhëniet e Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).....	28
VI.1.	Ngritja dhe funksionimi i grupeve të punës, në kuadër të konsolidimit administrativ dhe financiar të njërive të vetëqeverisjes vendore (bashkive), në vijimësi të reformës administrativo-territoriale.....	28
VI.2.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.....	35
VI.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor.....	37
VII.	Funksionet e deleguara, kryerja e veprimtarisë nga institucionet të cilave u janë deleguar funksionet nga institucionet qendrore.....	38
VII.1.	Verifikimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore .....	38
VII.2.	Shërbimet sociale .....	40
VII.3.	Zhvillimi i territorit.....	41
VII.4.	Zhvillimi i turizmit.....	41
VII.5.	Shërbimi i Gjëndjes Civile.....	44
VIII.	Organizimi dhe veprimtaria e administratës së Prefektit.....	45
VIII.1.	Organizimi.....	45
VIII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	47
VIII.3.	Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	57
VIII.4.	Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	49
VIII.5.	Veprimtaria e N/Prefektit.....	50
IX.	Veprimtari të tjera të Prefektit.....	50
X.	Objektivat për vitin 2017.....	50

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2016

#### I. HYRJE

Raporti, i cili paraqet veprimtarinë dhe performancën e Institucionit është në pajtueshmëri me kërkesën për rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike

Raporti pasqyron realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës. Në raportin pasqyrohet programimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga bashkitë e qarkut, si dhe nga institucionet qendrore në nivel vendor; Treguesit e punës; marrëdhëniet e Prefektit me administratën qendrore dhe rajonale, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë); Bashkëpunimi dhe koordinimi punës për realizimin e detyrave të ngarkuara; Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore; Problemet e rendit e sigurisë publike, antitrafikimi i qënieve njërezore, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në vazhdim; Transferimi nga pushteti qendror tek bashkitë i funksioneve të shërbimit zjarrfikës, administrimit të pyjeve, sistemit të ujitjes dhe kullimit, menaxhimit të rrjetit të rrugëve rurale, sistemit të arsimit parashkollor dhe kryerja e ketyre funksioneve nga ana e bashkive. Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të turizmit; Përballimit të situatave të emergjencave civile; Kryerjes së funksioneve të deleguara; Vlerësimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore. Po kështu në raport trajtohen problemet e ndjekjes dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve; Urdhrat e nxjerra nga ana e Prefektit dhe zbatimi i tyre; Problemet e konstatuara gjatë analizave vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, etj.

Për hartimin e raportit përveç të dhënave të institucionit dhe të dhënave monitoruese, janë përdorur edhe të dhënat e institucioneve qendrore në nivel qarku, si dhe të dhënat e bashkive

## II. PËRMBLEDHJE

Gjatë vitit, si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, është përmirësuar performanca e institucioneve qendrore në nivel vendor si dhe e njësisve të vetëqeverisjes vendore. Me kalimin e disa funksioneve tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, është mundësuar që shërbimet të jenë më afër qytetarit.

Arritjet në realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës, janë rezultat i rritjes së nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike.

Të ardhurat e realizuara në nivel qarku (Tatime, taksa dhe kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore), të arkëtuara nepermjet Drejtorisë Rajonale të Tatimeve janë realizuar me një vlerë prej 4,849,524 mijë lekë, ose 103 %, me një rritje nga viti 2015 prej 512,966 mijë lekë, ose 11.8 %. Ndërsa nga dega e Doganës janë realizuar 3,617,000 mijë lekë.

Të ardhurat e njësisve të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe Këshilli i qarkut) janë realizuar me një vlerë prej 802,225 mijë lekë, ose 81.2 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 186,210 mijë lekë, ku peshën më të madhe me 91,422 mijë lekë, ose 49 % të mosrealizimit e zë bashkia Shkodër. Megjithëse të ardhurat e programuara nuk janë realizuar, krahasuar me vitin e kaluar janë tejkaluar.

Në rritjen e të ardhurave ndikim të rëndësishëm ka patur rritja e të ardhurave nga turizmi, të cilat pasqyrojnë zhvillimin që ka marrë ky sektor në saje të masave, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat dhe subjektet që zhvillojnë aktivitetet në fushën e turizmit, si dhe investimeve të kryera në infrastrukturë në shërbim të këtij sektori.

Gjatë vitit janë kryer investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 1,027,741 mijë lekë (Këshilli i qarkut 17,705 mijë lekë, bashkia Shkodër 92,506 mijë lekë, bashkia Malësi e Madhe 620,196 mijë lekë, bashkia Vau i Dejës 182,835 mijë lekë, bashkia Pukë 92,843 mijë lekë dhe bashkia Fushë Arëz 22,656 mijë lekë)

Janë kryer investime nepermjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit me vlerë 1,543,032 mijë lekë, për Restaurimin dhe muzealizimin e Fototekës “Marubi”; Rikonstruksion i rrugës Tamarë-Vermosh; Rivitalizim i ndërtesave dhe shëtitorës lumit “Cemir” Tamarë

Janë kryer investime gjatë vitit me fondet e buxhetit, përmirësimi i infrastrukturës (ndërtim e rikonstruksion në 21 shkolla dhe 5 palestra e ambiente sportive) me vlerë 352,371 mijë lekë; Nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë janë programuar fondet për ndërtimin e bazës prodhuese (bazës për kryerjen së praktikave profesionale) në shkollën mesme industriale “A.Broci” me vlerë rreth 192,000 mijë lekë: Është kryer Rikonstruksioni i teatrit “Migjeni” Shkodër. Po kështu janë kryer investime nga ana e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe Sh.A me kapital shtetëror; KESH-Njësia Periferike HEC Vau i Dejës me vlerë 28,443 mijë lekë; KESH-Njësia Periferike HEC Koman me vlerë 169,565 mijë lekë; OSHEE, Drejtorja Rajonale Shkodër me vlerë 395,609 mijë lekë; Ujësjiellësi Fshat Shkodër Sh.A me vlerë 53,915 mijë lekë; RTSh (për antenat Tarabosh) me vlerë 2,991 mijë lekë, Spitali Rajonal Shkodër; Universiteti i Shkodrës “L.Gurakuqi”, etj.

Si rezultat i investimeve të kryera nga OSHEE, masave të marra dhe bashkëpunimit me institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me strukturat e policisë vendore, është përmirësuar cilësia e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, duke patur një furnizim pa ndërprerje. Po kështu si rezultat i punës është zvogëluar niveli i humbjeve në rreth 42 %, niveli më i ulët gjatë viteve të fundit.

Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor, përfshirë edhe krijimin e laboratorëve të informatikes dhe sigurimin e internetit në të gjitha shkollat. Në tre shkolla, për klasat dixhitale (kl.X e XI-të) ofrohen tableta për nxënësit; Në dy shkolla të qytetit Shkodër janë pajisur me bazën e nevojshme materiale laboratorët shkencor; Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimi nxënësve me aftësi ndryshe (Janë caktuar 12 mësues mbështetës për zhvillimin normal të procesit mësimor të 53 nxënësve me aftësi ndryshe, nga 1 që ishte vitin e kaluar; Numri i fëmijëve që kanë braktisë shkollën për shkak të gjakmarrjes ka rënë në 3, nga 5 që ishte vitin e kaluar; Gjatë vitit nuk asnjë mësues pa arsimin përkatës dhe jashtë profilit.

Megjithëse numri i të punësuarve në sektorin publik ka rënë, numri i të punësuarve në total gjatë vitit është rritur me rreth 1410 vetë (numri i të punësuarve, të cilët kanë derdh kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore është 27675 vetë, nga 26266 vetë që ishte në vitin 2015), për rrjedhojë ka rënë të numrit të punëkërkuësve të papunë të regjistruar me 4038 persona, ose rreth 34 % (Punëkërkuës të regjistruar 7920 persona, nga 11958 persona që ishte në vitin 2015). Në fund të vitit ka patur 270 vende të lira, të cilat kërkojnë njohuri të veçanta për profesionin, ose janë punë të cilat nuk terheqin punëkërkuësit. Gjatë vitit është intensifikuar goditja ndaj informalitetit, çka shihet edhe në treguesit e rritjes së të ardhurave, të subjekteve private të regjistruara dhe në numrin e të punësuarve.

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nepermjet inspektimeve dhe kontroleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për administrimin e fondeve të ndihmës ekonomike, janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 696 familje, të cilat e përfitonin në shkelje të ligjit. Po kështu nepermjet komisionit dhe rikomisionit janë larguar nga skema e pagesës 524 persona me aftësi të kufizuar.

Situatat e emergjencave të krijuara gjatë gjithë vitit në territorin e qarkut (situatat dimerore të krijuara nga reshjet dhe ato verore nga renia e zjarreve) si rezultat i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e policisë së shtetit, autoritetin rajonal të rrugëve, shërbimin pyjor, strukturat e MM, me mbështetjen e vazhdueshme të MPB (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile) janë përballuar me sukses.

Kriminaliteti gjatë vitit, krahasuar me vitin 2015, është ulur në masën 3.5 %, ose me 99 vepra penale më pak (Nga 2752 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2015 në vitin 2016 janë evidentuar 2653).

Trafikimi i qënjeve njerezore, ka patur rënë të treguesve të evidentimit, e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit të Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njërive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit.

Ka rënë të ndjeshme të rasteve të prerjes së paligjshme dhe dëmtimeve në pyje, mbi 85 % (Gjatë vitit janë konstatuar prerje të paligjshme të drurve të përmasave të ndryshme 1393 copë me 172 m<sup>3</sup> nga 9500 copë me 1450 m<sup>3</sup> që ishte në vitin 2015).

Është intensifikuar puna, për për eliminimin e shitjes së duhanit të grirë në tregje informale, mbajtjen e transportimin pa pullë fiskale, si dhe për shmangien e fenomenit të fshehjes së detyrimit nga akciza.

Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit, ushtrimit te pergjegjesive dhe veprimtarise jane nxjerre 54 Urdhra; Jane zhvilluar takime te shumta si me grupin keshillues pranë Prefektit, ashtu edhe me drejtues te institucioneve qendrore ne nivel vendor, te njesive te veteqeverisjes vendore, etj., per problemet e emergjencave civile, mbarevajtjen e sezonit turistik, titujt e pronesise mbi token bujqesore, ligjshmerine e akteve te nxjerra nga njesite e

vetëqeverisjes vendore, sistemin e adresave, etj ; Jane shqyrtuar dhe vlerësuar, duke u kthyer përgjigje, 117 kërkesa dhe ankesa te ndryshme te qytetarve.

Institucioni i Prefektit gjatë vitit ka qenë pjesë përbërse e grupit ndërinstitucional (task forces) së ngritur për evidentimin e problemeve në kopshte e çerdhe (publike e private); Ka qenë pjesë përbërëse grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Reabilitimin e Shtretërve të Lumenjëve, të ngritur në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nr 309, datë 31.05.2016; Ka qenë pjesë e grupit operacional të përbashkët, për marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private, të ngritur në zbatim të VKM Nr. 215 datë 16.03.2016 “Për krijimin e task-forcës Roja e Gjelbër”. Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat vendore të policisë së shtetit, lidhur me zbatimin e plan-veprimit për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.

Nga 332 akte të depozituara, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në Institucionin e Prefektit, për verifikim ligjshmërie, Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore 225 akte; Është shprehur negativisht, për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për 79 akte; Janë dhënë rekomandime, këshillime në ato raste kur ka qenë e domosdoshme, për 28 vendime me karakter jo normativ. Ka vazhduar asistimi me ndihmë juridike në mënyrë qoftë verbalisht apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e drejtë të tij

Nga ana e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore janë ushtruar kontrollet direkte për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të AMTP – ve të plotësuar në tokat bujqësore të ish NB të qarkut (Në fshatrat Grudë e Re e Shtoj i Ri të NJA Rrethina, pjesë e ish NB ”Perlat Rexhepi”, Bërdicë e Sipërme dhe Mesme të Bërdicë, pjesë e ish NB “Bërdicë”, Rranxa, NJA Bushat, pjesë e ish NB Bushat); Janë trajtuar me përgjigje administrative 101 kërkesa. Janë pezulluar rreth 68 dosje deri në momentin që organi i akuzës të shprehet në lidhje me AMTP, duke qenë se origjinalet nuk ndodhen në arkivat e Zyrave Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por janë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Janë pezulluar 25 dosje deri në çeljen e deshmise së trashëgimisë; Janë në proces verifikimi administrativ 249 dosje; Janë trajtuar me vendime, për shfuqizim të plotë/pjesëshëm 45 AMTP dhe ka kaluar në favor të Shtetit/ Bashkisë 21. 8 ha tokë.



### III. BAZA LIGJORE

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin Nr. 8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
- Ligjin Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligji Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligji Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 9131, date 08.09.2003 “Per rregullat e etikes se administrates publike”
- Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me ndryshime
- Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj Nr.9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- Ligji nr. 9154, date 06.11.2003 “Per arkivat”, me ndryshime
- Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime
- Ligji Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime
- Ligji nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSh”, me ndryshime
- Ligji nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshime
- Ligji nr 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik”, me ndryshime
- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshime
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “Për inspektimin financiar publik”
- Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me ndryshime
- Ligj Nr. 9482, datë 06.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me ndryshime
- Ligj Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me ndryshime
- Ligj Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me ndryshime
- Ligj Nr. 68/2014 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligj Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligj Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”
- Ligji 8756 date 26.03.2001 “Për Emegjencat Civile”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8951 datë 10.10.2002 “Për numrin personal të shtetasve”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime
- Ligji nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”
- Ligji Nr. 9948 date 07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”
- Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- Ligji Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10129 date 11.05.2009 “Per gjendjen civile”, me ndryshime
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit

#### **IV. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË**

##### **IV.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave**

Janë realizuar të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 802,225 mijë lekë, ose 81.2 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 186,210 mijë lekë, ku peshën më të madhe me 91,422 mijë lekë, ose 49 % e mos realizimit i përket bashkisë Shkodër. Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore paraqitet, sipas pasqyrës:

Në mijë lekë

Nr	Njësia e Vetë qeverisjes vendore	Te ardh. gjithsej		Te ardh. tatimore		Te ardh. jo tatimore	
		Program	Fakt	Program	Fakt	Program	Fakt
1	Keshilli i Qarkut	4,291	4,291	64	64	4,227	4,227
2	Bashkia M. Madhe	173,577	135,106	129,711	116,718	43,866	18,388
3	Bashkia Puke	28,095	28,095	9,194	9,194	18,901	18,901
4	Bashkia Fushe-Arrez	20,371	20,371	8,232	8,232	12,139	12,139
5	Bashkia Vau i Dejes	162,000	105,683	107,915	68,480	54,085	37,202
6	Bashkia Shkoder	600,101	508,679	366,259	341,076	233,842	167,603
	<b>Totali</b>	<b>988,435</b>	<b>802,225</b>	<b>621,375</b>	<b>543,764</b>	<b>367,060</b>	<b>258,460</b>

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 4,849,524 mijë lekë, ose 103 % e të ardhurave të programuara, me një rritje nga viti 2015 prej 512,966 mijë lekë, ose 11.8 %. Të ardhurat e programuara dhe të realizuar, sipas llojit paraqiten sipas pasqyrës:

Në mijë lekë

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2016			2015	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Tatim mbi vlerën e shtuar	460,001	536,302	117	460,784	116
2	Ttim-fitimi	275,001	365,085	133	281,490	130
3	Tatim mbi të ardh. personale	640,999	617,849	96	609,539	101
4	Taksa nacionale	52,001	35,189	68	37,813	93
	Totali Tatime	1,428,002	1,554,425	109	1,389,626	112
5	KONT.SIGUR.	3,269,999	3,295,099	101	2,946,932	112
	<b>Totali</b>	<b>4,698,001</b>	<b>4,849,524</b>	<b>103</b>	<b>4,336,558</b>	<b>112</b>

Nga dogana janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 3,617,000 mijë lekë, ndërsa nga Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me vlerë 58,238 mijë lekë.

#### IV.2. Realizimi i Investimeve

Gjatë vitit janë kryer investime nga njësitet e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 1,027,741 mijë lekë (Këshilli i qarkut 17,705 mijë lekë, bashkia Shkodër 92,506 mijë lekë, bashkia Malësi e Madhe 620,196 mijë lekë, bashkia Vau i Dejës 182,835 mijë lekë, bashkia Pukë 92,843 mijë lekë dhe bashkia Fushë Arëz 22,656 mijë lekë), me të dhëna sipas pasqyrës:

Nr.	Investimet sipas objekteve dhe njësive te vetëqeverisjes vendore	Vlera në lekë
<b>Këshilli i qarkut</b>		
1	Orendi per zyra	322,000
2	Rikonstruksion i fasadave ne hyrje te Shko	15,361,839
3	Pajisje zyrash	261,990
4	Kompjutera	224,664
5	Rikonstruksion shpatullave te ures Gorice	1,098,090
6	Kolaudator rikonstruksion shpatullave te urës Gorice	2,040

7	Fikese zjarri	129,600
8	Orendi per zyra	305,010
<b>Shuma</b>		<b>17,705,233</b>

**Bashkia Malësi e Madhe**

1	Skema Ujitese me kanalin Shtoder,Rragam zona Mbishkoder-kanalet sekondare (rehabilitim i pjesshem)	48,000,000
2	Blerje eskavator me zinxhire	16,347,131
3	Rehabilitimi i banesave ne bashkepronesi	10,580,521
4	Rehabilitimi i qendres se qytetit Koplik (FZHR)	208,796,331
5	Ndertim pedonales fshati turistik Razem (FZHR)	17,935,349
6	Rikonstruksion shkolla 9-vjecare "Prek Gjoni" Bajze (FZHR)	45,450,800
<b>Investime me fondet nga inst.qendrore</b>		<b>301,659,332</b>
8	Ndertim pedonales fshati turistik Razem	4,536,709
9	Supervizim & kolaudim i objektit ndertim pedonales fshati turistik Razem	282,631
10	Detyrime te mbartura Investime & diferenca te trasheguara	3,185,697
11	Blerje Fadrome	4,000,000
12	Paisje dhe orendi per shkolla	396,000
13	Rikonstruksion Konvikti Tamare	760,800
14	Blerje Kontenier pastrimi	4,200,000
15	Riparim i rrjetit elektrik (Ndriçimit)M.Madhe & supervizim & kolaudim	1,291,271
16	Supervizim & kolaudim Rehabilitim i qendres se qytetit Koplik	2,856,244
17	Sistemim Asfaltim Rruga Bratosh Kastrat Rapshe & supervizim & kolaudim	20,217,426
18	Ndertim Ure ne fshatin Hysaj-Njesia Adm. Gruemire & supervizim & kolaudim	12,248,832
19	Investim Rikonstr . Rrugesh dytesore & supervizim & kolaudim	5,722,739
20	Sistemim Asfaltim Rruga e Kaldrunit & supervizim & kolaudim	20,217,426
21	Sistemim Asfaltim Rruga e Reçit & supervizime & kolaudime	59,533,128
22	Rikonstruksion Bashkia Malesi e Madhe & supervizim& kolaudim	12,259,064
23	Autovetura per policine e ndertimit dhe Bashkiake	4,000,000
24	Orendi per Zyre administrata	936,000
25	Rikonstruksion Qendra Shendetesore Linaj	504,042
26	Supervizim & kolaudim- Rehabilitim i banesave ne bashkepronesi	126,772
27	Sistemim Asfaltim Rruga Dedaj Lohe & supervizim & kolaudim	20,217,426
28	Sistemim Asfaltim Rruga Xhami - Bogiq & supervizim & kolaudim	12,076,784
29	Supervizime dhe kolaudime per Investime	1,261,760
30	Projekte te gjithe perfshira	6,000,000
31	Bashkefinacim projekte	10,000,000
32	Rikonstruksion Banjo Shkolla 9- Vjeçare Hysaj	771,600
33	Brerje Stufa (dru zjarri)	788,000
34	Rikonstruksion Ndertese e Zjarrfikeseve	840,000

35	Ndertim trotuare & ndriçim Rruga Mehaj	395,480
36	Sist.asf.rruga Çek-Dedaj	12,759,351
37	Plan.rrug.&uj.s.Qend.Koplik-Rrethrr.supert.-rr.Boge	23,455,525
38	Rikonstruksion rruga Gruemire- Linaj - Egç	960,000
39	Blerje makine teknologjike	3,996,000
40	Superv. & Kolaudim -Rikonstr.shkolla 9-vjecare "Prek Gjoni" Bajze	200,400
41	Gjenerator + gur flesibel-PMNZH	120,000
42	Rikonstruksion rruga Qender Bajze - rrotondo	67,419,879
<b>Investime me fondet për bashkinë</b>		<b>318,536,986</b>
<b>Shuma</b>		<b>620,196,318</b>

#### Bashkia Shkodër

1	Blerje paisje TIK	4,417,200
2	Ristrukturim fizik dhe teknik të Dhomës së	198,000
3	Rikonstruksion sheshe plazhi Velipoje	2,943,016
4	Rikualifikim urban i ambjenteteve të jashtme	19,020,150
5	Rikonstruksion i Bllokut të pallateve "Xhabiej"	5,408,040
6	Blerje kazana metalike dhe kosha mbeturina	16,692,000
7	Blerje paisje TIK	659,880
8	Zbatimi i projektit per ndertimin e leres	669,613
9	Rikonstruksion rruge dytesore grupi IV	10,083,078
10	Kom Rrethina Sistemin asfaltim Rruga Q Gru	96,000
11	Sarr Bardhaj qender Nja rrethina	3,149,932
12	Rikonstruksion degezimi rruga Pal Ejlli	709,008
13	Shpronosime	374,290
14	Blerje stufa per ngrohje	480,000
15	PC për qendrat komunitare	303,960
16	Printer për qendrat komunitare	96,000
17	Blerje paisje TIK	914,876
18	Blerje pajisje operacionale	1,433,520
19	Blerje rafte per biblioteken	276,000
20	Rafte per biblioteken	56,000
21	Blerje libra e gazeta	787,440
22	Rafte per biblioteken	170,200
23	Pajisje teknike per zyre dhe evente kultur	150,000
24	Ruajtja e Galerise se Arteve Kamera Siguri	106,800
25	Permiresimi i kushteve teknike te ambjente	527,400
26	Orendi zyre	76,800
27	Pajisje dhe risistemim i fondit te arkives	418,800
28	Mobilimi me orendi per mjediset e Galerise	64,500
29	Mobilim per Qendren Kulturore "Pjeter Gaci	428,400
30	Pajisje zyre per Qendren Kulturore "Pjeter	134,040
31	Blerje pajisje zyre komp+fotokopje	95,232
32	Sistem i kamerave te sigurise	94,800
33	Mobilim i dhomave te 10 aktoreve	316,800

34	Blerje paisje teknike profesionale	540,000
35	Mobilimi i 2 dhomave per te ftuarit	134,400
36	Blerje kompjuter, printer	40,000
37	Tapet per ringun e boksit	32,000
38	Rikonstruksion 3 dhoma+2 banjo e dushe	385,000
39	Blerje kompjuter, printer	39,992
40	Tapet per ringun e boksit	75,000
41	Rikonstruksion 3 dhoma+2 banjo e dushe	213,798
42	Blerje pajisje (orendi)	239,880
43	Blerje pajisje zyre dhe vendosje interneti	104,000
44	Shpronetime	3,599,495
45	Investime ndricim rruge dytesore +mbikqyrj	5,626,320
46	Rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"	118,460
47	Rikonstruksion rruge "Qazim Llazani"	198,707
48	Rikonstruksion degezim rruge "Draçin"	559,818
49	Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Dr	513,962
50	Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardelev	323,854
51	Rikualifikim Urban blloqe banimi"Tepe-te f	1,102,440
52	Projekt i plote Rehabilitimi i sheshit ç	666,562
53	Rikonstruksion rruga Bulevardi Skenderbeg	559,818
54	Rikonstruksion rruga Osja i Falltores (bll	393,593
55	Rikonstruksion rruga Edit Durham (tek shko	228,322
56	Rikonstruksion rruga Mandave	447,090
57	Rikonstruksion rruga Smakej	106,997
58	Rikonstr. rruga Oblike-Velinaj-Alimetaj (s	119,999
59	Investime ndricim rruge dytesore +mbikqyrj	174,000
60	Projekt i plote Rikonstruksion i godines s	1,591,410
61	Studim projektim rruga sheshi hidrovor	900,000
62	Studim projektim KUZ,RECI RI	906,000
63	Kaldaja shkolla Xheladin Fishta	45,560
64	Rikonstruksion i plote e shkolles "Oso Kuka"	166,800
<b>Shuma</b>		<b>91,506,052</b>

#### Bashkia Vau i Dejës

1	Rikonstruksion i godines Bashkia Vau Deje	1,263,014
2	Rikostruksion i godinave te njesive admin	3,653,189
3	Rikonstruksion i Godines Bashkise Vau-deje	5,000,000
4	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.25	474,248
5	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.13	536,501
6	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.16	5,927,854
7	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U.20/1	299,405
8	Rehabilitimi i kanalit ujitës K.U Bushat R	918,035
9	Rikualifikim i qendrës së qytetit, Faza I	62,500,007
10	Lyerje dhe riparim shkollash mesme te qyte	4,765,673
11	Supervizim dhe kolaudim shkollave mesem Ba	24,000
12	Rrethim shkolles 9-vjecare Kosmac	2,998,839

13	Supervizim dhe kolaudim shkolles 9-vjecare	45,000
14	TVSH e projektit Japonez	1,417,216
15	Lyerje dhe Riparim shkollash 9 vjecare kop	3,134,811
16	Sistemim asfaltim i rruges Stacioni i Tren	24,003,084
17	Sinjalistike rrugore(qender qyteti-rruga e	778,800
18		
19	Sistemim asfaltim, rruges varrezave Rranxa	7,664,478
20		600,000
21	Blerje tubacioni betoni Ø 800 dhe Ø 500	600,000
22		
23	Shtrese betoni ne Rrugicen e lagjes Lisen	119,894
24	Supervizim i objektit :Ndertim i ures HD=8	118,800
25	Supervizim i objektit :Ndertim argjinature	118,800
26	Blerje kazane mbeturinash dhe betonim te v	7,370,400
27	Meremetim Objektesh shkollore(Rik.Shk.Nara	1,271,784
28	Lyerje dhe Riparim shkollash 9 vjecare kop	3,887,092
29	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare, Topla	8,218,582
30	Rikonstruksion i godines Bashkia Vau Deje	5,744,574
31	"Rehabilitim per shkollat VauDejes - shkol	7,086,078
32	Pergatitje projekti "Rik. Godina Bashkise	119,100
33	Pergatitje projekti "Rik. Godina Nj.A.Vig-	120,000
<b>Shuma</b>		<b>182,834,882</b>

#### Bashkia Pukë

1	Tabela orjentuese per zonat turistike	100,000
2	Blerje tabela per njesite vendore	69,696
3	Blerje tabele elektronike B Puke	120,004
4	Sistemim i lagjes pas pallatit të kulturës	13,737,468
5	Rigjenërim i shëtitiores qëndrore	57,992,397
6	Mulli bloje Lumzi	1,189,914
7	Mulli bloje lagja Rrype	1,074,871
8	Ura kembesore pasarel Kabash	1,312,224
9	Ndertim ura Hadroj	601,974
10	Ndertim ure kembesore Blinisht	136,800
11	Investim ne fasada,trotuare ndricim Qyteza	15,206,027
12	Bashkefinansim ne projekte	258,000
13	Punime,sherbime ne ura	132,000
14	Riparim Ambulanca Kabash(godina)	227,640
15	Punime ne stadium	683,880
<b>Shuma</b>		<b>92,842,895</b>

#### Bashia Fushë Arëz

1	Projektim per Objektivin Rikonstruksion Shkolle	360,000
2	Sistemim asfaltim,trotuare dhe ndricim	22,242,824
3	Supervizim dhe kolaudim per objektin Efic	52,800
<b>Shuma</b>		<b>22,655,624</b>

Janë kryer investime nepermjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit me vlerë 1,543,032 mijë lekë, për Restaurimin dhe muzealizimin e Fototekës “Marubi”; Rikonstruksion i rrugës Tamarë-Vermosh; Rivitalizim i ndërtesave dhe shëtitorës lumit “Cemit” Tamarë, me të dhënat, sipas paqyrës:

Nr.	Emertimi i objektit	Burimi i Financimit	Vlera e investimit (mijë Leke)	Data e fillimit të projektit	Data e mbarimit të projektit
1	Restaurimi dhe muzealizimi i Fototekës Marubi	IPA HERA, AADF FZHR 2014	152,810	18 Maj 2015	9 Maj 2016
2	Rivitalizimi i ndërtesave dhe shëtitorja e lumit në Tamarë	FZHR	56,264	14 Shtator 2015	30 Maj 2016
3	Rikonstruksioni i rruges Tamare - VERMOSH, Lot 1	KFW- IPA 2009	749,224	21 Shtator 2014	21 Gusht 2016
4	Rikonstruksioni i rruges Tamare - VERMOSH, Lot 2	KFW- IPA 2009	584,734	27 Korrik 2015	24 Nëntor 2016
	<b>Shuma</b>		<b>1,543,032</b>		

Janë kryer investime gjatë vitit me fondet e buxhetit, përmirësimi i infrastrukturës (ndërtim e rikonstruksion në 21 shkolla dhe 5 palestra e ambiente sportive) me vlerë 352,371 mijë lekë, nga Ministra e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë janë programuar fondet për ndërtimin e bazës prodhuese (bazës për kryerjen së praktikave profesionale) në shkollën mesme industriale “A.Broci” me vlerë rreth 192, 000 mijë lekë. Rikonstruksion i teatrit “Migjeni” Shkodër. Po kështu janë kryer investime nga ana e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe Sh.A me kapital shtetëror; KESH-Njësia Periferike HEC Vau i Dejës me vlerë 28,443 mijë lekë; KESH-Njësia Periferike HEC Koman me vlerë 169,565 mijë lekë; OSHEE, Drejtoria Rajonale Shkodër me vlerë 395,609 mijë lekë; Ujësjellësi Fshat Shkodër Sh.A me vlerë 53,915 mijë lekë; RTSh (për antenat Tarabosh) me vlerë 2,991 mijë lekë, Spitali Rajonal Shkodër; Universiteti i Shkodrës “L.Gurakuqi”

## V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor)

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkoder në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkepunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e veteverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrorjnë aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e Institucioneve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionet në nivel Qarku.

I është kushtuar rëndësi e vecantë zbatimit të VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave” dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.



Prefekti ne rolin e Kryetarit dhe si përgjegjës për planizimin e emergjencave civile në qark, vazhdimisht ka organizuar e bashkërenduar punën për hartimin e planeve të perballimit të emergjencave civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes si dhe ndërhyrjet për menaxhimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore, njëkohësisht ka kërkuar në vazhdimësi zbatimin e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, duke bashkërenduar dhe koordinuar veprimtarinë e ndërsjelltë të njesive të veteqeverisjes vendore, institucioneve dhe në menyre të vecante me struktura drejtuese të policisë vendore me të cilat niveli i bashkëpunimit ka qene shume i mire

## V.1. Institucionet qendrore në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre

### 1.1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të tatimeve të ardhurat janë realizuar në masen 103 %, me një rritje nga vitit i kaluar prej 11.8 %. Janë regjistruar gjatë vitit 2161 subjekte private dhe në fund të vitit numri i tatim paguesve ka arritur në 11106. Gjatë vitit megjithëse numri i të punësuarve (personave të cilët derdhin kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore) në sektorin publik ka pësuar rënie, në total ka pësuar rritje, krahasuar me vitin 2015, me 1409 vetë. Sipas të dhënave të Drejtorisë rajonale të Tatimeve, për kontribuuesit, numri i të punësuarve për vitin 2015 dhe 2016 paraqitet:

Nr.	Emërtimi (sipas sektorëve dhe statusit)	Numri i të punësuarve, sipas vitit	
		2016	2015
1	Në sektorin publik	9417	10156
	a. buxhetor	8822	9444
	b. jobuxhetor	595	712
2	Në sektorin privat	18258	16110
	a. Subjekte fizike	5591	5247
	b. Subjekte juridike	12667	10863
	Gjithsej	27675	26266

Janë ushtruar kontrole dhe vizita fiskale në subjekte në 216 raste dhe për subjektet të cilat kanë rezultuar se zhvillojnë aktivitet jo në përputhje me ligjin përveç masave administrative me gjobë, janë bërë konfiskime në 42 raste. Të ardhurat e realizuara, numri i subjekteve të regjistruara i cili ka pësuar rritje, numri i të punësuarve (kontribuuesve), i cili ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, tregojnë jo vetëm për masat e marra ndaj informalitetit, por janë tregues të përmirësimit të punës e performances së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve

### 1.2. Dega e Doganës Shkodër

Janë realizuar të ardhura me vlerë 3617000 mijë lekë, ose 88 % (nga 4110227 mijë lekë të programuara)

Nepermjet implementimit të metodave të reja dhe teknologjisë është mundësuar ofrimi i procedurave të shpejta dhe korrekte doganore, duke nxitur kështu tregtinë e lirë.

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për marrjen e masave në zbatim të Ligjit Nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për eliminimin e shitjes së duhanit të grirë në tregje informale, si dhe mbajtjen e transportimit pa pullë fiskale, me qëllim shmangien e fenomenit të fshehjes së detyrimit nga akciza.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, veçanërisht me struktura e policisë është bërë sekuestrimi i 506 kg duhan i grirë, dhe në 6 raste materialet procedurale i janë referuar prokurorisë

### **1.3. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të ushqimit**

Puna e Drejtorisë është përqendruar e realizimin e planeve të Inspektimeve të miratuara nga DPAKU; Në realizimin e detyrimeve të planifikuara të treguesve financiar; Në zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit në PIK. Për gjetjet e konstatuara gjatë ushtrimit të 2522 kontrolleve (kontrolle të ushtruara nga 3 sektorët e AKU, Sektori i Inspektimit me Origjinë jo Shtazore, Sektori i Inspektimit me Origjinë Shtazore dhe Sektori i Mbrojtjes së Bimeve dhe Imputeve Bujqësore) janë vendosur gjithsej 9 “gjoba” me vlerë prej 840 mijë lekë; 512 masa administrative “Paralajmerime” për rregullimin e mangesive të kostuara në Operatoret e Biznesit Ushqimor; Janë bllokuar 1422 kv mallra ushqimore dhe janë asgjësuar 330 kv mallra ushqimore.

Gjate kontrolleve të ushtruara, janë vënë re dhe disa fenomene (kryesisht për operatoret e biznesit “njësi tregtare” apo “ruajtje në temperatura ambjenti” magazine) ku të metat e konstatuara dhe mundësitë e korigjimit të tyre kanë lënë për të dëshiruar, pasi ka të bëjë me mënyrën e ndërtimit të objektit (mure, dysheme, çati), duke mosplotësuar që rrjedhin kryesisht nga detyrimet e zbatimit të udhëzimit Nr. 22 datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjenes për stabilimentet e ushqimit dhe operatoreve të biznesit ushqimor” tek objektet e marra me qera.

### **1.4. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore**

Nga dega e arkivave, është bërë i mundur sistemimi i të gjithë rregjistrave dhe borderove të tërhequra nga arkivi vendor qendror duke i dhënë kështu arkivave të vjetërsisë në punë, modelin e kërkuar në baze të ligjit të arkivave, gje e cila mundëson edhe zgjidhjen me të shpejtë të nevojave për këto vjetërsi të popullatës.

Në tremujorin e parë të vitit ka përfunduar futja në sistem e të gjithë pensioneve për pagesat online. Janë informatizuar dhe vazhdon procesi i hedhjes në sistem të listpagesa të subjekteve shtetërore dhe private si dhe i rregjistrave të grumbulluar në vazhdimësi.

### **1.5. Drejtoria e Rajonale e Shërbimit Kombëtar të punësimit**

Me fondet e buxhetit janë kryer pagesa papunësie dhe për nxitje punësimi me vlerë 97,104 mijë lekë (Pagesë papunësie 63,535 mijë lekë, nga 64,477 mijë lekë të programuara, ose 98.5 % dhe Nxitje punësimi 33,569 mijë lekë nga 34,826 mijë lekë të programuara, ose 96.4 %)

Janë regjistruar punëkërkuar të papunë 7920 persona (Shkodër 5263 persona), ose 66.2 % krahasuar me vitin 2015 (gjatë vitit janë regjistruar punëkërkuar të papunë 11958 persona, nga të cilët për Shkodrën 7736 persona), ose me një diferencë më pak 4038 persona.

Nga punëkërkuar të papunë të regjistruar (ku 3011, ose 38 % i perkasin moshë mbi 50 vjeç; 1597, ose mbi 20 % i perkasin moshës deri 29 vjeç) 4157 trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 344 me pagesë papunësie

Gjatë vitit, sipas vendeve të lira të punës të krijuara kryesisht në sektorët e prodhimit të këpucëve, konfeksioneve, përpunim peshkut, telemarketingut, etj. prej 2511 (për Shkodrën 2071 vende të lira), nga të cilat për programet e nxitjes së punësimit 655, janë shpallur 2360, ose rreth 94 % e tyre, nga vetë punëdhënësit janë shpallur 2192 vende të lira, ose rreth 87.3 %

Nga vendet e lira dhe të shpallura janë plotësuar 2286, ose 91 % (për Shkodrën janë plotësuar 1965 vende), nga të cilat 870, ose 34.6 % janë plotësuar nga zyra e punësimit.

Nëpërmjet programe të nxitjes së punësimit që kanë në fokus kryesisht punësimin e pu.pa. nga grupet në vështirësi gjatë vitit janë punësuar: qarku 219 pu.pa (Shkodra 187), ndërsa numri i pjesëmarrësve gjithsej është 335 pu.pa (Shkodra 280)

Ndër vendet e vështira për t'u plotësuar vazhdojnë të jenë vendet e lira të shpallura nga nd/je përpunim peshkut (duke patur parasysh vetë kushtet e vështira të punës në këtë profesion);

Në sektorin e telemarketingut (duke patur parasysh strukturën e punëkërkuessve të papunë të përshtatshëm për këto vende pune, që të kenë njohuri të nivelit të lartë si në gjuhën e huaj dhe njohuri kompjuterike); Në profesionet qepës lëkurash dhe tekstilësh (duke mos qenë tërheqëse për punëkërkuessit). Kontigjenti që mund të jetë i mundshëm për t'u orientuar drejt këtyre profesioneve aktualisht është shumë i kufizuar, sepse kërkesa për këto profesione është për gra dhe vajza, njëkohë që niveli i punësimit i grave dhe vajzave vazhdon të jetë i lartë, në krahasim me atë të meshkujve, në këto sektorë.

Në fund të vitit ka patur 270 vende të lira pune, sipas sektorëve:

- i. ushqimor (përp.peshku) rreth 40
- ii. konfeksioneve rreth 63
- iii. kepuceve 8
- iv. telemarketingut rreth 40
- v. forcat e armatosura rreth 119

### **1.6.Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve**

Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, e organizuar me 4 sektor (Sektori i Inspektimit në mjedis dhe 3 sektor të inspektoratit të pyjeve, për bashkitë Shkodër e Vau i Dejës, Malësi e Madhe; Pukë e Fushë Arëz), mbështetur në VKM Nr. 103 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”

Gjatë vitit

- Nga Sektori i Inspektimit në Mjedis
  - Janë kryer 498 Inspektime
  - Janë marrë 7 Vendime Administrative, me Gjobë me vlerë 2 450 mijë lekë
  - Për 1 rast procedura i është dërguar për ndjekje penale Prokurorisë
  - Janë shqyrtuar 10 ankesa të qytetarëve, të cilat janë shqyrtuar dhe marrë masat brenda kompetencave ligjore.
- Nga Sektorët e Inspektoratit të Policisë Pyjore,
  - Janë kryer 687 inspektime (Shkodër 443, M.Madhe 117 dhe Pukë 127), nga të cilat në fondin pyjor e rrugë auto.563; gjueti 88 dhe subjekte 36, nga ku:
    - Janë konstatuar 26 raste të shkeljes së kërkesave ligjore.
    - Janë marrë 25 Vendime Administrative, me gjobë
    - Për 1 rast procedura i është dërguar për ndjekje penale Prokurorisë
    - Janë sekuestruar 451.9 m<sup>3</sup> lende drusore në 51 raste (296.4 mst dru zjarri në 37 raste dhe 155.5 m<sup>3</sup> lendë punimi në 14 raste)
    - Janë konstatuar dhe marrë pjesë në shuarjen e zjarreve në fondin pyjor e kullësor në 8 raste . Nga zjarret e rëna janë përshkuar 174.87 ha pyje komunal ( pyje 135.37 ha dhe kullota 39.5 ha); Janë djegur 8.07 ha (trungisht 5.57 ha, shkurre 2.5 ha), duke shkaktuar një dëm me vlerë 2,285,500 mijë lekë

### **1.7. Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor**

Duke patur si mision verifikimin e respektimin të kërkesave ligjore për garantimin e shëndetit publik, nga ana Inspektoriatit gjatë vitit:

- Janë kryer 5063 inspektime, sipas fushave:
  - i. Sanitare (mbrojtje e shëndetit nga produktet e duhanit) 2819
  - ii. Shëndetësore (klinika mjekësore, dentare publike e private, shërbim parësor, laborator jo publik, urgjenca spitalore) 361
  - iii. Kujdesin dhe sigurinë në punë (subjekte me mbi 15 punonj.) 62
  - iv. Institucione arsimore (parashkollor, arsimi parauniversitar e universitar, konvikte, etj) 361

- v. Turizëm (para dhe gjatë sezonit turistik në zonat turistike në pishina, struktura akomoduese, bar-restorante, pika shitje me shumicë e pakicë, etj.) 360
- vi. Operatorët e furnizimit me ujë të pijshëm (ujësjellësa) 38
- vii. Të tjera (inspektime me kërkesë të subjekteve për akt-miratim higjienosanitar; Marrje mostre të kripës jonizuar; Marrje mostre të ujit të ambalazhuar; etj.)

- Janë marrë masa administrative, gjoha në 74 raste, me vlerë 14,065 mijë lekë, nga të cilat, për mbrotjen e shendetit nga produktet e duhanit 38 raste me vlerë 10,855 mijë lekë; Mungese të librezave shendetesore 26 raste me vlerë 260 mijë lekë; Në laboratore dhe klinika mjekesore 8 raste me vlerë 1,850 mijë lekë; Moszbatim detyrash të lëna 3 raste me vlerë 600 mijë lekë; shkelje të rregullave higjieno sanitare 1 rast me vlerë 500 mijë lekë:

### **1.8. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik**

Janë bërë 1103 regjistrime në kurse të ndryshme profesionale dhe komplementare, të cilët janë në proces apo kanë përfunduar kualifikimin, në kurset Gjuhë e juaj; Njohuri kompjuterike; Hidraulik; Instalime të rrjetit elektrik; Mekanik; Rrobaqepës; Instalim e Riparim Sistemeve Ngrhëse Ftohëse; Instalim e Riparim Panele Diellore; Berber; Sekretar; etj. Në bashkëpunim me shkollën e mesme profesionale industriale “Arben Broci”, janë certifikuar 15 kursantë në profilin “Mekanik automjetesh”. Pas mbarimit të kurseve, sipas kërkesave dhe nevojave të subjekteve publike e private, një pjesë e personave të çertefikuara janë punësuar

### **1.9. Arsimi**

Gjatë vitit me fondet e buxhetit është bërë përmirësimi i infrastrukturës (ndërtim e rikonstruksion në 21 shkolla dhe 5 palestra e ambiente sportive)

Nga Ministra e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë janë programuar fondet për ndërtimin e bazës prodhuese (bazës për kryerjen e praktikave profesionale) në shkollën e mesme industriale “A. Broci” me vlerë 192, 000 mijë lekë

Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor, përfshirë edhe krijimin e laboratorëve të informatikes dhe sigurimin e internetit në të gjitha shkollat. Në tre shkolla, për klasat dixhitale (kl.X e XI-të) ofrohen tableta për nxënësit; Janë pajisur me bazën e nevojshme materiale laboratorët shkencor dy shkolla të qytetit Shkodër; Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe (Janë caktuar 12 mësues mbështetës për zhvillimin normal të procesit mësimor të 53 nxënësve me aftësi ndryshe, nga 1 që ishte vitin e kaluar; Numri i fëmijëve që kanë braktisë shkollën për shkak të gjakmarrjes ka rënë në 3, nga 5 që ishte vitin e kaluar; Gjatë vitit nuk asnjë mësues pa arsimin përkatës dhe jashtë profilit.

### **V.2. Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim**

Gjatë vitit krahasuar me vitin e kaluar 2015 kriminaliteti është ulur në masën 3.5 %, ose me 99 vepra penale më pak (Nga 2752 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2015 në vitin 2016 janë evidentuar 2653)

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2015 e 2016, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	
			2015	2016
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në prokurori	Numër	2752	2653
2	Vepra penale për të cilat janë zbuluar autorët	“	2138	1943
	Persona të implikuar,	“	2612	2444
	Nga të cilët			
	-U është privuar liria (arrestuar)	“	767	837
	-Janë ndaluar	“	131	236
	-Janë ndjekur në gjëndje të lirë	“	1409	1173
	-Janë shpallur në kërkim, pasi janë larguar, apo i fshihen drejtësisë	“	293	192
	-Kanë ndërruar jetë (në rrethna të vërtetuar proceduralisht)	“	12	6

Gjatë vitit nga shërbimet policore janë evidentuar dhe referuar në prokurori 2653 vepra penale. Nën drejtimin e prokurorive të rretheve gjyqësore nga veprimtaria hetimore-gjurmuese shërbimet policore kanë arritur të mbledhin fakte dhe prova, duke zbuluar e dokumentuar autorësinë e 1943 veprave penale, me një zbulueshmëri 73 %.

Është intensifikuar puna, për për eliminimin e shitjes së duhanit të grirë në tregje informale, mbajtjen e transportimit pa pullë fiskale, si dhe për shmangien e fenomenit të fshehjes së detyrimit nga akciza (Gjatë vitit si rezultat i bashkëpunimi të strukturave të policisë me Degën e Doganës janë sekuestruar 506 kg duhan i grirë, si dhe në 6 raste materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë)

Nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit gjatë vitit janë konstatuar 41 shtetas të vendeve Arabe, të cilët kanë tentuar të kalojnë në mënyrë të paligjshme në drejtim të territorit të Malit të Zi me destinacion vendet e europës perendimore; Janë deguar në QMH Kareç 7 shtetas; Janë derguar në qendrën e azilkerkuesve Tiranë 34 shtetas; Jane ripranuar dhe kaluar tranzit 2 shtetas të huaj (Kosovare); Janë ndjekur penalisht 15 shtetas të huaj (2 shtetas grek, 2 Italian, 1 Gjerman, 1 Iranjan, 1 Turke, 1 Maqedonasa, 1 Belg dhe 6 shtetas kosovar), për vepra kriminale të ndryshme; Kanë aplikuar për leje qëndrimi 583 shtetas të huaj, nga të cilët 305 shtetas për leje qëndrimi në qarkun Shkodër. Nga analiza e veprimtarisë vjetore është arritur në konkluzion se tendencat e veprave gjatë vitit kanë qenë Kalimi i personave të shpallur në kërkim; Kondrabanda me mallra të akcizes dhe mallra të tjera; Kalimi i paligjshëm i kufirit; Fallsifikimi i leternjoftimeve, pasaportave ose vizave; Trafikim mjete motorike; Trafikimi i narkotikeve; Kultivimi i bimëve narkotike; Dhenje ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit; Peshkim i ndaluar

### **Rekomandime për përmirësimin e punës**

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (pasi me shtrirjet e mëdha territoriale, mundësitë e fenomeneve të kriminalitetit janë më të mëdha), duke krijuar struktura (grupe) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjellta të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre, ku kërkohet një bashkëpunim më intensiv me administratorët e njësive administrative dhe të lagjeve dhe kryetarët e fshatrave për evidentimin, njohjen dhe identifikimin e jo vetëm të zonave dhe sipërfaqeve tashme të njohura të kultivimit të bimëve narkotike por edhe të personave tashme të skeduar nga policia, të cilët duhet të jene edhe në siten e skanimit të drejtuesve të të gjitha niveleve

Në luftën kundër përhapjes së bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e vazhdueshme:

- Në periudhën e mbjelljes (Punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm)
- Njësitë administrative, fshatrat, zonat dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike)
  - b. Përmirësimin e sinjalistikës rrugore dhe disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njërive të vetëqeverisjes vendore.
  - c. Hartimin e planeve të përbashkëta operacionale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërrjellta për parandalimin, ndërhyrjen dhe menaxhimin e situatave të emergjente.
  - d. Marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik
- 2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Drejtorinë Rajonale, zyrat arsimore, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitet, por as nga nxënësit dhe studentët, pasi janë kontingjenti më i mundshëm.
- 3. Bashkëpunimi me institucionet e kultit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe organet e drejtësisë, për evidentimin e personave me tendencë terroriste, apo propaganduese e bashkëpunuese me strukturat e ISIS

### **V.3. Problemet e konstatuara nga analizat mujore të punës të institucioneve qendrore në nivel vendor**

**Nga analizat e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, janë konstatuar:**

- Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe nje sfide vecanerisht per zonen periferike te qyteteve, perfshi njesite administrative Rrethina, Postribe, Ana e Malit, Gruemire, Guri Zi, etj. Megjithe masat dhe permiresimin e sherbimit, akoma mbeturinat digjen ne zona te caktuara dhe bile edhe brenda kontinjerve (kazaneve) duke u bere shkak i rritjes se semundshmerise se qytetarve me ndotjen e mjedisit.
- Gjëndja e krijuar në menaxhimin e Lëndfillit Bushat, si rezultat i të ardhurave të pamjaftueshme të krijuara me çmimeve të ulëta të depozitimit të mbetjeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ardhura të cilat nuk mbulojnë as koston e funksionimit, pa përfshirë investimet, duke zvogëluar afatin e përdorimit nga mbushja.
- Mosregjistrimi i punëkerkuesve të papunë, duke mospërfutuar edhe shërbimet shëndetësore për arsye të mungesës së kartës së shëndetit.
- Mospërmushja e detyrimit ligjor, për të raportuar lidhur me vendet e lira të punës (neni 21 i Ligjit Nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me ndryshime), nga subjektet publike
- Shitja e duhanit të grirë në tregje informale, pa pullë fiskale duke iu shmangur pagesës së akcizës

### **V.4. Grupet e punës ndërinstitucionale (task-forcat)**

Institucioni ka qenë pjesë përbërse e grupit ndërinstitucional (task forces) së ngritur për evidentimin e problemeve në kopshte e çerdhe (publike e private), grup i cila pas evidentimit problemet e konstatuara i ka dërguar në Ministrinë e Arsimit, ku është ngritur dhe funksionon grupi në shkallë vendi.

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat vendore të policisë së shtetit, lidhur me zbatimin e plan-veprimit për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike

Është ndjekur zbatimin e Aktit normativ të Këshillit të Ministrave Nr.4 datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për thyerjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”.

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nr 309, datë 31.05.2016 “Për ngritjen e grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Reabilitimin e Shtretërve të Lumenjëve” në përberje të grupit ka qene edhe specialisti i Prefekti, grup i cili pas punës në terren (nga zona e Dibres deri në derdhje të lumit Buna) gjatë periudhës Shtator –Nentor, ka përgatitur informacionin me të dhenat dhe dërguar Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Në grupin operacional të përbashkët të ISHMP, Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit dhe Policisë Ushtarake, të ngritur për marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private (në zbatim të VKM Nr. 215 datë 16.03.2016 “Për krijimin e taskë-forcës Roja e Gjelbër”) si pjesë përbërëse, ku gjatë vitit:

- Jane hartuar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e policisë qarkut Shkodër me komisaritet e policisë në rrethet për bashkëpunim konkret, ngritjen e grupeve të përbashkëta të patrullimit në postblloqe fikse si dhe ato të lëvizshme për parandalimin dhe ndëshkimit të rasteve të transportit të kundërligjshëm të lëndës drusore e deri në kontrollet e befasishme dhe të programuara në zonat pyjore me problematike për dëme në fondin pyjorë (Që nga muaji Prill e në vazhdim si grup Task Force Roja e Gjelbert, sipas grafikeve të miratuara nga ISHMP-ja dhe Drejtoria e Pol. Vendore Shkoder, kanë funksionuar postblloqet fikse dhe ato të lëvizshme në akset kryesore me të nxehta për transportin e paligjshëm të lëndës drusore dhe konkretisht për Bashkinë Pukë e Fushe Arrez në Luf e Gomsiqe, për bashkinë Shkoder e Vaudejes tek Ura e Mesit e Qaf-Lac dhe për bashkinë Malesia e Madhe në Dedaj-koplik)

- Bashkëpunimi ka dhënë rezultatet e veta pozitive që në fillim të vitit me shpalljen e moratoriumit në pyje ashtu edhe në muajt e fundit të vitit për disiplinimin dhe venien nën kontroll të prerjeve abuzive të drurëve pyjorë dhe transportit të paligjshëm të tyre, sidomos për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të v.2016, gjatë zbatimit të VKM nr 348 për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së lëndës drusore për furnizimin e popullatës me dru zjarri, rezultate të cilat konsistojnë.

• në ndalimin e prerjes së paligjshme të pyjeve në shkallë qarku (ka një rënie të ndjeshme të numrit të drurëve të prerë në mënyrë të paligjshme e krahasuar me vitet me përpara gjithsej në **1393** cope të diametrave të ndryshme me **172 m<sup>3</sup>, nga 9500 copë e afro 1450 m<sup>3</sup>**, që ishte në vitin 2015.

• vetëm gjatë muajit nëntor 2016 është arritur nga grupi operacional Task Force e Gjelbert të kontrolloheshin disa nga zonat pyjore me problematike sidomos si në Shllak-Cukal, Brucaj-Sumë, Razem-Fushe e Zeze, Terbun-Munelle e Qaf Mali, me zbatimin e VKM 438, për kriteret e shfrytëzimit të shitjes së materialeve drusore, për disiplinimin e tyre dhe abuzimet e mundshme për prerjet e paligjshme të pyjeve dhe transportin e paligjshëm të lëndës drusore sipas bashkive të Qarkut Shkoder si; Shkoder, Vaudejes, Pukë, Fushe Arrez e Malesisë e Madhe.

●Janë marrë masa për mbojtjen nga gjuetia e paligjshme, sidomos për zonat e Mbrojtura te Liqenit te Shkodrës, Lumi Buna dhe Velipoje.

#### **V.5. Masat ndaj antitrafikimit të qënieve njerëzore** **Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Personave, zbatimi i** **Planit të Veprimit 2014-2017**

Trafikimi i qënjeve njerëzore, ka patur rënie të treguesve të evidentimit, e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit te Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njërive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit. Është bërë riorganizimi i Komitetit Rajonal Antitrafik dhe Tryezave Teknike dhe është hartuar Plani i Veprimit në mbështetje të Strategjisë Kombëtare në Luftën kundër Trafikimit të Qënjeve Njerëzore. Vemendje e veçantë i është kushtuar nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, Komiteti Rajonal dhe Tryezat Teknike të organizuara, realizimi i 36 takimeve dhe aktiviteteve, si fushata ndërgjegjësuese dhe informuese

Nga puna e KRAT është bërë i mundur identifikimi i dy viktimave të trafikimi dhe dy viktimave të mundshme trafikimi. Nga viti i kaluar vazhdojnë të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dy persona si viktimat trafikimi. Gjithashtu është hartuar një plan veprimi për një person si viktimë trafikimi, për përfshirjen në programet e riintegritimit. Janë bërë 13 vlerësime të situatës familjare të fëmijët, prindërit e të cilëve janë në emigrim.

● Janë identifikuar:

- 66 persona deportiv
- 45 persona që i është refuzuar hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë
- 281 persona që i është refuzuar dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë
- 87 fëmijë në situatë rruge ku për secilën nga këto raste janë krijuar planet e ndërhyrjes për fuqizimin dhe integrimin , mbështetjen me ndihma ushqimore, veshmbathje, janë siguruar ilaqe për fëmijët dhe të rriturit të sëmure, mbështetje psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedura administrative, punësim, ndihmë ekonomike.

- 86 fëmijë jetim

- 4.263 familje me kryefamiljare gra (të divorcuara që trajtohen në skemën e ndihmës ekonomike)

● Janë ndaluar 41 persona me origjinë nga vendet arabe.

●Janë regjistruar nga gjendja civile pranë Bashkisë Shkodër 12 fëmijë të komuniteti rom dhe Egjiptian.

●Është bërë e mundur (nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër) punësimi i 4 personave (dy personave nga komuniteti Rom dhe Egjiptian në profilin e rrobaqepësisë dhe dy personave me denime alternative në profilin mekanik)

●Jane realizuar 10 takime me organet e pushtetit vendor dhe kryepleqtë e fshatrave në afërsi të kufirit mbi sensibilizimin e e qytetarëve mbi rregullat e kalimit, lëvizjen, qëndrimin, sansionet dhe kërkesën për azil në zonën Shengen.

Insitucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër në bashkëpunim me anëtarët e Komitetit Rajonal ka bërë të mundur për herë të parë konceptimin, dizenjimin dhe printimin e 1000 fletëpalosjeve dhe 100 posterave, si dhe stampimin e 500 bluzave me logon e KRAT Shkodër me mesazhe sensibilizuese mbi fenomenin e trafikimit të cilat janë përdorur në 18 aktivitetet e realizuar në kuadër të muajit antitrafik, ndersa posterat janë vendosur në rrugët kryesore të qytetit të Shkodrës.



## V.6. Masat e marra për përbalimin e situatave nga emergjencat

Mbi bazën e planit vjetor të miratuar, në të cilin janë parashikuar dhe planifikuar të gjitha detyrat e sektorit, të shtrira sipas muajve por edhe sipas specifikave të emergjencave të pritshme që e karakterizojnë territorin e Qarkut Shkodër bazuar edhe në përvojën e krijuar në vitet e shkuara, është organizuar dhe kryer veprimtaria gjatë vitit, e cila konsiston:

- Janë organizuar 6 mbledhje të KECQ (në muajin Janar, Shkurt, Maj, Korrik, Tetor, Nendor), ku janë deleguar detyra për përbalimin e emergjencave sezonale dhe marrjen e masave planifikuese dhe organizative për emergjencat e pritshme.

- Janë hartuar Planet e Masave, planet e gadishmerisë planet e bashkëpunimit sistemet e lajmerimit, numërat e kontaktit si dhe Urdhërat perkatës me detyra të detajuara për çdo takim të KECQ .

- Janë hartuar planet e evakuimit për zonat që rrezikohen nga përmbytjet dhe që izoloohen nga dëborat me të gjithë strukturat anetare të KECQ.

- Në zbatim të VKM Nr.965, datë 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave” i është kërkuar informacion me shkresë zyrtare në mënyrë periodike të gjithë bashkive, për ngritjen e strukturave të emergjencave konform këtij VKM, të cilat janë ngritur por vazhdojnë me mangësi dhe akoma jashtë kriterëve që përcakton Vendimi i mësëprëm i KM, pasi akoma nuk është plotësuar struktura si Drejtori Emergjencash në Bashkinë Shkodër, gjë që krijon probleme në ndjekjen në dinamikë me profesionalizëm dhe me kompetencë të menaxhimit të emergjencave në këtë Bashki.

- Duke i kushtuar vëmendje grumbullimit të dhënave për zbatimin e detyrave të planizimit të emergjencave të pritshme dhe evidentimin e resurseve logjistike dhe njerëzore që disponojnë çdo bashki, i është dërguar një Plan shabllon emergjencash e cila të plotësohet sipas specifikave të çdo bashkie për planifikimin dhe përbalimin e emergjencave të pritshme. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme intensive dhe këmbëngulëse të Institucionit të Prefektit, akoma nuk është bërë e mundur që nga këto bashki të bëhet një plan mirefilltë emergjencash, apo të krijohet një bazë të dhënash për resurset logjistik dhe njerëzor në një databazë ku të jenë të detajuara inventaret dhe kapacitetet e mundshme të planizuara.

- Vëmendje i është kushtuar ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe kordinimit dhe mbështetjes së strukturave anetare të KECQ për normalizimin e situatave të krijuara nga reshjet e shiut dhe të dëborës si dhe emergjencat verore. Është bashkëpunuar dhe inspektuar në bashkëpunim me Autoritetin Verior të Rrugëve për ndjekjen dhe mbikqyerjen e veprimtarisë së kësaj strukture në hapjen e akseve rajonale, eficienten aktuale të kompanive të kontraktuara për hapjen e akseve nacionale në të gjithë territorin e Qarkut. Për këtë janë bërë herë pas here inspektime konkrete edhe ballafaqime për cilësinë e këtyre strukturave për hedhjen e kripës e granilit në akset më problematike për shkak të ngricave dhe temperaturave të ulta. Për rrjedhojë viti 2016 është menaxhuar me sukses, duke siguruar dhe garantuar kalueshmërinë e mjeteve gjatë 24 orëve në të gjithë territorin e Qarkut Shkodër.

Si rezultat i vëmendjes dhe masave të marra për të bërë të kalueshme segmentet e rrugëve rurale, sidomos ato që lidhin qendrat e NJA me Bashkitë, si dhe falë edhe mbështetjes maksimale të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave për vënien në dispozicion të mjeteve borëpastruese (fadroma), të cilat u janë dhënë në përdorim NJA më problematike (për periudhën e dimrit), sic janë ato të Thethit, Kelmendit, Shoshit, Shalës, Pultit, bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz, është arritur hapja dhe zhbllokimi pa vonesë. Si konkluzion është konstatuar se situata e emergjencave dimerore në vitin që shkoi është menaxhuar, monitoruar me shumë kujdes, duke e konsideruar atë të suksesëshme si pasojë e kordinimit të këtyre të strukturave dhe mbikqyerjes maksimale të ndjekura sistematikisht nga

Institucioni i Prefektit. Vazhdon të ngelet problem tradicional i mbartur ndër vite bllokimi i segmenteve të Qafë Thores dhe atij që lidhe NJA të Postribës, Pultit, Shoshit, Shales, Thethit. Përpjekjet e Institucionit të Prefektit kanë qenë të vazhdueshme dhe këmbengulesë por specifika e këtij terreni e bën të domosdoshem tashmë një ndërhyrje definitive me një projekt të mirëstudiar i cili duhet të bëhet për ndërtimin e të gjithë këtij segmenti që nga pjesa e ngelur e pa përfunduar në Qafë Thore dhe vazhdimi e saj deri në Prekal duke lidhur NJA të mesipërme.

- Përsa i përket masave parandaluese dhe mbrojtëse për përmbytjet e mundëshme.

Kordinimi dhe ndërhyrja në kohe e Institucionit të Prefektit me institucionet anetare te KECQ, bëri të mundur edhe shmangien e një përmbytje të mundëshme në zonën e nënshkodres në muajin Tetor të vitit 2016.

Inspektimi elementeve parandaluese dhe mbrojtës si dhe ndërhyrje në pikat më problematike ka qenë një nga prioritetet i cili është organizuar në mënyrë periodike, sidomos në argjinatura sic është ajo e Lumit Kir, lumit Buna në zonën e Darragjatit. Po kështu gjatë vitit është bërë një ndërhyrje emergjente në NJA Kelmend, në riparimin e dy urave, të cilat u dëmtuan për shkak të vërshimit të përrrenjve.

- Emergjencat verore, Zjarret në pyje dhe kullota

Në muajin Qershor është organizuar mbledhja e KECQ për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota, është hartuar plani i masave dhe është dërguar urdhëri i Prefektit për të gjithë strukturat ligjzbatuese për menaxhimin e zjarreve të pritshme, ku vëmendje e vecantë i është kushtuar garantimit të parqeve kombëtare dhe plazheve dhe garantimit të turizmit malor për parandalimin e zjarreve dhe garantimin e sezonit turistik veror. Në këtë kuadër është siguruar bashkëpunimi me të gjitha strukturat vartëse të Ministrisë së Mjedisit, si Inspektoriati Pyjor, Inspektoriati Mjedisor, strukturat e Bashkive, DPQ për organizimin e vrojtimit dhe angazhimin e resurseve njerezor dhe logjistik menjëherë pas shfaqes së zjarreve sidomos në NJA Velipojë, Bushat, Vau Dejës, Shllak, Postribë, Theth, Gjegjan, Fushe Arrëz (sipas statistikes bashkëlidhur). Është bashkëpunuar dhe kemi siguruar mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave sidomos për territoret tepër të vështira për fikjen e zjarreve nëpërmjet ajrit.

Vazhdon të ngelet problem shqetësues mosangazhimi i strukturave bashkiake, dhe inkurajimi i sistemit vullnetar pranë cdo bashkie dhe NJA për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në territoret e përgjegjësisë së tyre.

- *Për zbatimin e Urdhërit të përbashkët të disa ministrive nr. 248, datë 28.01.2000 "Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave."*

Është kërkuar nga pesë bashkitë evidentimi dhe kontrolli i të gjitha digave dhe dambave në juridiksionin territorial të tyre dhe nga informacionet e marra konstatohet se ato elemente të konsideruar si damba janë jashtë funksionimit të tyre dhe nuk përbëjnë rrezike për popullatën. Edhe nga HEC Vau Dejës e Fierzë (sipas informacioneve të marra) janë ngritur shtabet për këtë qëllim dhe janë marrë masat e duhura për mirëmbajtjen, vrojtimin dhe sigurinë e digave dhe veprave shkarkuese, nëpërmjet grupeve të punës me specialistë përkatës.

*Veprimtaria e strukturave administrative që janë në varësi të drejtpërdrejtë të Prefektit të Qarkut për Emergjencat Civile.*

Është perfeksionuar bashkëpunimin, duke rifreskuar dhe abdetuar të gjitha skemat e njoftimit dhe të informimit të ndërsjelltë me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe

bashkitë që ushtrojnë aktivitet në territorin e Qarkut Shkodër, anëtarë të KECQ, sipas fenomenit të fatkeqësisë.

Është bashkëpunuar me OST për parandalimin e emergjences së rrezimit të shtylles të TL për shkak të gërryerjes nga Lumi Drin në fshatin Ganjollë, e cila rrezikonte përveç fatkeqësisë njerëzore edhe ndërprerjen e energjise elektrike për qytetin e Shkodres, ku me ndërhyrjen e Prefektit u bë e mundur spostimi i kësaj shtylle në një vend më të sigurt duke parandaluar fatkeqësi të mundëshme dhe situatë emergjente.

Nga kontaktet dhe bashkëpunimet që kemi patur gjatë vitit në të gjitha bashkitë e Qarkut janë ngritur KEC, janë hartuar planet e masave dhe janë deleguar detyrat për drejtoritë e varësive për menaxhimin e emergjencave sezonale.

Në Bashkinë Shkodër, gjatë përmbytjeve në muajin Maj në N/S Shkodra 2, u testuan konkretisht strukturat në varësi të kësaj Bashkie dhe u monitoruan nga Sektori Emergjencave duke parë konkretisht se si vepruan strukturat e kesaj bashkie për të stabilizuar situatën e krijuar nga reshjet në lagjet e Tepes, Dracinit, Perash, situatë e cila u menaxhua me sukses.

- Bashkëpunimi me strukturat e policisë shtetit (DVP dhe strukturat e saj), ka qenë i suksesshëm gjatë situatave emergjente të krijuara. Strukturat e policise kanë qenë shumë efektive në transmetimin e informacioneve dhe kanë treguar gadishmeri maksimale në stabilizimin e qarkullimit rrugor në rastete e ngricave dhe ndihmen ndaj komunitetit në nevojë në të gjitha situatat emergjente.

- Edhe me strukturat e Shtabit të Përgjithshëm, ato të Rep. 1010, të dislokuar në Bashkinë Vau Dejes kemi bashkëpunuar intensiv, në bazë të planeve Operacionale sidomos në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota që gjatë vitit që shkoi kanë qenë të shpeshta në NJA Velipojë, Bushat, Vau Dejes, Theth, Postrinë, Fushë Arrëz, Pukë.

Nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm kemi garantuar kontrollin dhe sigurimin e territorit nga municionet e pa plasura në Bashkinë Shkodër, duke siguruar operacionet e strukturave të specializuara të MM, deri në garantimin e pastrimit të plotë të territorit për fillimin e punimeve për bërjen e lulishtes nga firma përkatëse në Lagjen Xhabije. Ndërhyrje për asgjësimin e municioneve të pa plasuar kemi patur edhe në NJA Gjeggjan, Fushe Arrëz.

Në kuadrin e bashkëpunimit me Autoritetin Verior Rajonal të Rrugëve ka patur në disa raste mosinformimin për grumbullimin e skorieve dhe kripës, si dhe për hartimin e kontratave me sipërmarrësit për akset e rrugëve rajonale që shtrihen në territorin e Qarkut, të cilat me ndërhyrjen e Institucionit të Prefektit janë eliminuar.

### **Propozime dhe probleme që kërkojnë mbështetje për ndërhyrje.**

- Domosdoshmeria e miratimit të Ligjit të ri “Për Emergjencat Civile”, duke rregulluar edhe masen e fondit rezervë për rastet e emergjencave (pasi fondi rezervë në masën deri 3 %, nuk mund të përballojë nevojat për përballimin e situatave që mund të krijohen gjatë vitit) është imediat për mirëfunksionimin e strukturave në varësi të bashkive dhe ato në nivel qendror me qëllim menaxhimin më eficient të situatave të pritshme në të gjithë territorin e Qarkut.

- Përcaktimi i nivelit të mardhenieve në mes strukturave të emergjencave civile në bashki me Institucionin e Prefektit është një domosdoshmeri për delegimin dhe ndjekjen më përgjegjeshmeri të situatave të pritshme dhe mbi të gjitha shfrytëzimit të resursëve njerëzore dhe logjistike pranë cdo bashkie, duke minimizuar kërkesat pa kriter që bëhen për cdo emergjence pranë Institucionit të Prefektit dhe duke lënë pa shfrytëzuar kapacitetet dhe burimet e veta.

- Ndërhyrjet në sistemin mbrojtës dhe parandalues në NJA të zonës Neshkodres

## **VI. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Marrëdhënieit e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njesite e vetëqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në mënyrë qoftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nenligjore.

Është bashkëpunuar për transferimin e funksioneve nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësite e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës specifike) për kryerjen e ketyre funksioneve

### **VI.1. Ngritja dhe funksionimi i grupeve të punës, në kuadër të konsolidimit administrativ dhe financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkive), në vijimësi të reformës administrativo-territoriale**

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) dhe institucionet qendrore për transferimin e funksioneve nga Ministrinë dhe institucionet qendrore të bashkitë, si pjesë e paketës decentralizuese, duke bere transferimin ne pronesi te tyre te pasurise, si dhe duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten specifike) per kryerjen e ketyre funksioneve, për:

#### **1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin**

Në mbështetje të VKM Nr 366 datë 18.05.2016 ‘Për transferimin në pronësi, të bashkisë, të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi’ janë ngritur komisionet nga Institucioni i Prefektit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Nga ana komisioneve te ngritura, për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të inventarit të PMNZSh-së, eshte bere kalimi aktiveve te qendrushme dhe qarkulluese, sipas inventarve dhe dokumentacionit perkates, kalim i cili eshte dokumentuar me procesverbalet perkatese per bashkine Shkoder, Malesi e Madhe dhe Puke

Transferta specifike per kryerjen e shërbimit te MZSh-se ka qene me vler 50 247 mije leke (Per bashkine M.Madhe 8 057 mije leke, Puke 11 512 mije leke dhe Shkoder 30 678 mije leke), me nje rritje nga vitit i kaluar (kur shërbimi ka qene i perqendruar ne Institucionin e Prefektit) me nje vlere prej 1 656 mije leke).

#### **1.2. Rrjetin e rrugëve rurale**

Mbështetur në pikën 3 të VKM Nr. 915 datë 11.11.2015, “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, Institucioni ka mbikëqyrur procesin e transferimit në pronësi nga Këshilli i Qarkut Shkodër tek njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), sipas të cilit:

Këshilli i Qarkut Shkodër, në zbatim të Vendimit të mësipërm të KM dhe Udhëzuesit të Agjencisë Zbatimit të Reformës Territoriale, për zbatimin e VKM

- Ka ngritur Grupin e punës për ndjekjen e procesit të transferimit

- Ka marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësit e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale Shkodër, duke respektuar afatet, procedurat dhe mënyrat e përcaktuara në kodin e punës.

- Ka vendosur për mbylljen e Ndërmarrjes
  - Është bërë transferimi (duke hartuar e nënshkruar dokumentacionin e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim nga komisionet e përbashkëta të Këshillit të Qarkut dhe bashkisë përkatëse), i rrjetit rrugor, aseteve të luajtshme e të paluajtshme dhe mjeteve motorike e pajisjeve, sipas inventarit (miratuar në VKM, sipas tabelave perkatëse), për bashkinë Shkoder, Malesi e Madhe, Vau i Dejes, Puke dhe Fushe Arez (bashkia Shkodër ka patur pretendime lidhur me gjendjen e mjeteve motorike)
    - Nuk është bërë transferimi, në bashkinë Malësi e Madhe, për
      - Asete të qëndrueshme (2 zyra të ish sektorit Malësi e Madhe-Ndërmarrja e Mirëmbajtjes Rrugëve Rurale në ndërtesën e Bashkisë Koplak, pasi këto zyra kanë qenë dhe janë pronë e bashkisë.
      - Mjete motorike (Eskavator Bjellorus, duke mos qene gjendje fizike)
    - Gjatë procesit të transferimit, një problem i pa trajtuar dhe që kërkon zgjidhje mbetet dokumentacioni i ish Ndërmarrjes që nga krijimi, i cili ruhet në arkivin e Këshillit të qarkut

Transferta specifike për menaxhimin e rrugëve rurale ka qenë me vlerë 54 689 mijë leke (Për bashkinë Fushë Arez 12 866 mijë leke, Malesi e Madhe 12 367 mijë leke, Puke 6 159 mijë leke, Shkoder 17 857 mijë leke dhe Fushe Arez 5 440 mijë leke), afërsisht aq sa ishte në vitin e kaluar (kur menaxhimi i rrugëve bëhej nga Ndërmarrja e Rrugëve Rurale, në varesi të Këshillit të Qarkut), vit në të cilin ishin programuar të kyeshin edhe investime me një vlerë prej 17 000 mijë leke, ose mbi 5 000 mijë leke me shumë krahasuar me vitet 2013 e 2014.

### 1.3. Pyjet dhe kullotat publike

Mbeshtetur në VKM Nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, është mbikqyrur procesi dhe bashkëpunuar njesitë e veteqeverisjes vendore për transferimin në pronësi të tyre të pyjeve dhe kullotave, proces i cili ka patur probleme kryesisht me personelin.

Është në proces regjistrimi në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave të transferuara

Transferta specifike për kryerjen e funksionit të administrimit të pyjeve dhe kullotave ka qenë me vlerë 16 656 mijë leke (Për bashkinë Fushe Arez, Malesi e Madhe, Puke dhe Shkoder me 3 679 mijë leke secila dhe për bashkinë Vau i Dejes 1 840 mijë leke), nga 13 369 mijë leke që ka qenë në vitin e mëparshëm (kur funksioni i administrimit të pyjeve kryhej nga drejtoria e Përgjithshme e pyjeve nepermjet Drejtorisë Rajonale të Sherbimit Pyjor), ose me një rritje prej 3 187 mijë leke.

### 1.4. Sistemin e ujitjes dhe kullimit

Mbeshtetur në VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit” dhe Udhëzimit Nr. 541/1 Prot, datë 31.12.2015 të Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale, është ndjekur duke u monitoruar transferimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe personelit tek bashkitë (Në grupet e punës të ngritura ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Institucionit të Prefektit). Është kryer transferimi në bashkitë Fushe Arez, Puke, Vau i Dejes, Malesi e Madhe. Po kështu është kryer transferimi edhe në bashkinë Shkoder, por transferimi ka patur disa probleme, të cilat janë

krijuar nga mospercaktimi i sakte i ndarjes se pasurise ne mes Sektorit te Bordit Kullimit dhe bashkise, probleme te cilat kane sjell vonesa ne transferim dhe per rrjedhoje edhe ne ushtrimin e funksioneve.

Transferta specifike per kryerjen e funksionit te ujitjes dhe kullimit ka qene 23 876 mije leke (Per bashkine Fushe Arez dhe Puke 2 198 mije leke secila, Malesis e Madhe e Vau i Dejes 4 046 mije leke secila dhe per bashkine Shkoder 11 388 mije leke)

Me fondet e miratuara nga buxheti, për rikonstrukcionin e kanaleve të ujitjes (VKM Nr. 90, edate 04.02.2016) bashkise Shkoder i jane akorduar 10 000 mije leke, per projektin “Rehabilitimi i pjesshem i skemës ujitëse Gur i zi – Juban” (transferte e kushteyuar). Pas kryerjes se procedures prokurimit eshte lidhur kontrata me kontraktorin me vlere 6 036 mije leke, i cili ka kryer punimet e kontraktuara.

Nga rishperndarja e fondeve per investime per funksionet e ujitjes dhe kullimit (blerjen eskavatorve dhe rehabilitimin e skemave ujitese), si diference nga procesi i prokurimit te fondeve, ne mes bashkive perfituese ka qene edhe bashkia Vau i Dejes.

### **1.5.Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar**

Në buxhetin e vitit 2016, jane transferuar tek njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) fondet për kryerjen e kryerja e funksioneve të arsimit parashkollor (personeli mësimor dhe jomësimor), arsimi parauniversitar (personeli jomësimor, punonjësit mbështetës) dhe konvikte të arsimit parauniversitar. Është bërë transferimi i personelit, sipas dokumentacionit dhe janë kryer shpenzimet për paga e sigurime shoqërore e shëndetësore, që nga Dhjetor 2015 e në vazhdim.

Gjatë vitit ka patur probleme, lidhur me mungesën e fondeve për paga e sigurime shoqërore e shëndetësore për punonjësit e arimit parashkollor (kopshtet), edukatorët dhe punonjësit në qendrën kulturore të fëmijëve, punonjësve mbështetës në arsimin parauniversitar (arsimin bazë), transferuar bashkisë Shkodër, me vlerë 7,431 mijë lekë, si dhe për punonjësit mbështetës të arsimit të mesëm me vlerë 2,078 mijë lekë, fonde të cilat megjithë kërkesat e bashkisë, nuk janë akorduar nga MAS.

### **1.6. Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të ndotura**

Mbështetur në VKM Nr.63, date 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, është ndjekur, duke e monitoruar, procesi i riorganizimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura në bashkitë, sipas të cilit:

#### **Bashkia Pukë**

Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime e krijuar sipas VKM Nr. 173 datë 26.03.2004, nga transferimi i kapitalit të “Ujësjellës-Kanalizime Pukë sha”, në varësi të Bashkisë Pukë, ka funksionuar me status të dyfishtë (si ndërmarrje shtetërore dhe si shoqëri aksionere)

Ndërmarrja nuk është transferuar me inventarin dhe kapitalin që është përcaktuar në raportin e ekspertit kontabël, për problemet në lidhje me mungesën e një inventari kontabël sipas dosjeve teknike të objekteve të ujësjellësit, amortizimin e tyre, etj (është në përfundim vlerësimi kontabël dhe fizik, për subjektet që do të ndahen).; Janë përgatitur edhe kryer të gjitha veprimet e duhura për “Ujësjellës-Kanalizime Pukë sha”, që do ndahet ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Fushë Arrëz; Është bërë: transferimin e aksioneve të ish komunave të

rrethit Pukë te aksionerët, Bashkia Pukë dhe Fushë Arrëz, sipas ndarjes së re administrative, duke bërë edhe regjistrimin e aksioneve; Është ndryshuar statuti; Po punohet për inventarizimin dhe ndarjen e saj në të dy ndërmarrjet sipas aksioneve që zotërojmë secila dhe është përgatitur projekt raporti i ndarjes të sha “Ujësjetllës Kanalizime Pukë”. Është në proces regjistrimi i shoqërisë në QKB dhe përditësimi i të dhënave

### **Bashkia Shkodër**

Bashkia Shkoder, me grupin e punës (të ngritur me Urdhër nr 85, datë 04.03.2016), per marrjen ne dorezim te aktiveve te qendrueshme e qarkulluese te Ujesjellesit Fshat, ka përfunduar procesin e marrjes në dorëzim, nga Ndërmarrja e Ujësjetllësit Fshat Sh.a, për Ujësjetllësat e NjA Berdice, Ana Malit, Postrisë, Shalë, Guri Zi, fshatin Zues e Zogaj të NjA Rrethina. Nepermjet komunikimeve shkresore (nr 2390, datë 29.02.2016), i është kerkuar Ndërmarrjes Ujësjetllësit Fshat Sh.a ndryshimi i grafikut te dorezimit te ujesjellesave duke vene prioritete dorezimit e Ujesjellesit Velipoje, si zone turistike per marrjen e masave urgjente per pergatitjen e sezonit turistik. Po kshtu duke vene në dijeni Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizimeve) për ecurinë e procesit të transferimit, bashkia ka kerkuar ndërhyrje ne përcaktimin e grafikut të kerkuar dhe përshpejtimin e procesit të transferimit (shkresë nr 3292, date 23.03.2016).

Eshte miratuar, nga ana e Këshillit bashkiak (Vendim Nr. 28, date 01.06.2016) statuti i ri i sh.a Ujesjellesit në përputhje me VKM Nr.63, datë 27.1.2016

Procesi i transferimit të ujësjetllësave akoma nuk ka përfunduar për Ujësjetllësin e NjA Rrethina, Velipojë, si dhe impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Velipojë

### **Bashkia Vau Dejës.**

Është miratuar nga Këshilli bashkiak (Vendim Nr. 24, datë 02.06.2016, i ndryshuar me Vendimin Nr. 51, datë 10.06.2016) krijimi i shoqërisë (riorganizimi, pasi shërbimi i furnizimit me ujë në territorin e bashkisë është kryer nepermjet 3 formave; a. Ndërmarrja e Ujësjetllësit Vau i Dejës për ish bashkinë; b.Sektori i Ujësjetllësit të NjA Bushat, për këtë njësi dhe nga c. Ndërmarrja e Ujësjetllësit Fshat Shkodër Sh.a, për NjA Temal, Shllak, Vig Mnelë e Hajmel) dhe statutit. Janë emëruar organet e shoqërisë; Ka përfunduar, procesit të vlerësimit të aseteve nga ekspertet e licencuara (të caktuara me vendim gjykate); Ka përfunduar marrja në dorëzim e aseteve të Ujësjetllësit Hajmel dhe Temal, pjesë e Ndërmarrjes së Ujësjetllësit Fshat sha; Është në shqyrtim dokumentacioni, lidhur me një investim të ri, të realizuar në territorin e Bashkisë Vau Dejës, nga Ndërmarrja e Ujësjetllësi Fshat (Nuk ka përfunduar akoma procesi i vlerësimit të këtij ujësjetllësi).

Është bërë rregjistrimi i shoqërisë së re pranë QKB (emërtimin “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës” sha, me NIPT L67302001M); Është në proces marrja e licencës për kryerjen e shërbimit (janë marrë miratimet higjieno sanitare). Deri në miratimin e tarifave të reja aplikimi do të bëhet sipas tarifave të miratuara nga ERRU, për ish Ndërmarrjen Vau i Dejës.

### **Bashkia M.Madhe**

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura është kryer nga Ndërmarrja e Ujësjetllësit Fshat Shkodër Sh.a, me sektorin për Malësinë e Madhe. Procesi i riorganizimit nuk ka përfunduar, duke qenë se kjo Ndërmarrje nuk ka dorëzuar akoma ujësjetllësin e Nj.A NjA Rrethina, Velipojë, si dhe impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Velipojë (brenda territorit të bashkisë Shkodër)

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera specifike), sipas bashkive

## 1. Bashkia Malësi e Madhe

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	2,112	1,926	353	332	1,582	1,522	0	0	0	0	4,047	3,779
Administrimi i pyjeve	01	04260	2,794	1,754	467	293	418	352	0	0	0	0	3,679	2,399
Mbrojtja e pr.buj.e blegt	01	04520	4,257	2,586	730	432	3,380	3,211	0	0	4,000	3,888	12,367	10,117
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	34,586	33,672	5,755	5,620	0	0	75	75	0	0	40,216	39,368
Arsimi i mesëm (përfshi konvikt.)	01	09230	5,155	5,064	865	849	1,032	1,032	22	22	1,157	924	8,231	7,891
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	5,993	5,536	1,030	924	906	809	99	83	0	0	8,028	7,352
<b>Totali</b>			<b>54,697</b>	<b>50,538</b>	<b>9,199</b>	<b>8,450</b>	<b>7,318</b>	<b>6,926</b>	<b>196</b>	<b>180</b>	<b>5,157</b>	<b>4,812</b>	<b>76,568</b>	<b>70,906</b>

## 2. Bashkia Shkodër

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	6,470	3,726	924	456	9,994	7,486			74,567		91,955	11,668
Administrimi i pyjeve	01	04260	2,794	2,302	466	367	419	49					3,679	2,718
Rrugë rurale	01	04520					17,857	7,603					17,857	7,603
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	40,007	39,805	6,612	6,612							46,619	46,417
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	37,180	35,489	6,228	5,982	32,806	26,473	227	206			76,441	68,150
Përkujdesi social	01	10430							17,044	15,646			17,044	15,646
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	23,434	22,881	4,016	3,843	3,052	2,783	277	277			30,779	29,784
<b>Totali</b>			<b>109,885</b>	<b>104,203</b>	<b>18,246</b>	<b>17,260</b>	<b>64,128</b>	<b>44,394</b>	<b>17,548</b>	<b>16,129</b>	<b>74,567</b>		<b>284,374</b>	<b>181,986</b>



### 3. Bashkia Vau i Dejës

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	2,112	2,112	352	352	1,582	1,582					4,046	4,046
Administrimi i pyjeve	01	04260	1,397	1,397	233	233	209						1,839	1,630
Rrugë rurale	01	04520	441	441							5,000		5,441	441
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	19,146	18,757	3,186	3,133							22,332	21,890
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	1,687	1,591	279	266							1,966	1,857
Arsimi (konviktet)	01	09240	6,997	6,997	1,403	1,403							8,400	8,400
<b>Totali</b>			<b>31,780</b>	<b>31,295</b>	<b>5,453</b>	<b>5,387</b>	<b>1,791</b>	<b>1,582</b>			<b>5,000</b>		<b>44,024</b>	<b>38,264</b>

### 4. Bashkia Pukë

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	528	528	88	88	1,582	101					2,198	717
Administrimi i pyjeve	01	04260	2,794	2,414	467	403	418	414					3,679	3,232
Rrugët rurale	01	04520	2,318	2,262	369	304	3,472	2,122					6,159	4,688
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	26,284	25,651	4,390	4,246							30,674	29,898
Arsimi i mesëm	01	09230	4,774	4,774	797	797							5,571	5,571
Arsimi (konvikti Pukë)	01	09240	5,925	5,742	942	942	5,760	4,737					16,627	11,421
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	8,760	8,326	1,474	1,389	1,279	988					11,512	10,703
<b>Totali</b>			<b>51,383</b>	<b>49,698</b>	<b>8,526</b>	<b>8,169</b>	<b>12,511</b>	<b>8,363</b>					<b>72,420</b>	<b>66,229</b>

## 5. Bashia Fushë Arëz

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	513	476	103	67	1,582	1,407					2,198	1,950
Administrimi i pyjeve	01	04260	2,794	2,794	467	467	418	418					3,679	3,679
Rrugët rurale	01	04520	5,736	5,626	978	916	6,152	5,829					12,866	12,371
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	20,058	18,778	3,500	3,116							23,408	21,894
Arsimi i mesëm (përfshi konvikt.)	01	09230	3,183	3,183	531	530							3,714	3,713
<b>Totali</b>			<b>32,284</b>	<b>30,856</b>	<b>5,429</b>	<b>5,096</b>	<b>8,152</b>	<b>7,654</b>					<b>45,865</b>	<b>43,607</b>

## **VI.2. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8927, datë 25.02.2002 "Për Prefektin" dhe ndryshimeve ligjore ligjit të ri nr.107/2016, hrë në fuqi finmd nëntori 2016, Prefekti i Qarkut Shkodër gjatë vitit ka vazhduar oponencën dhe bashkëpunimin me njësitë e veteqeverisjes vendore ne perputhje me aktet ligjore e nenligjore.

### **Ligjshmëria e akteve normative të miratuara nga organet e njësive të qeverisjes vendore**

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, njësitë e vetëqeverisjes vendore (5 bashki dhe Këshilli i Qarkut), janë depozituar gjithsej **332 akte normative**; nga të cilat:

-Për 225 akte normative Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore,

-Për 79 vendime është shprehur negativisht për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore,

-Për 28 VKB me karakter jo normativ të cilat janë depozituar, i janë dhënë rekomandime, këshillime në ato raste kur ka qenë e domosdoshme.

Reforma territoriale dhe qëndrimi institucional i prefektit nëpërmjet sektorit juridik vlerësohet se ka qenë frytdhënës, për shkak NJQV janë penguar të miratonin VKB për të cilat Prefekti është shprehur negativisht, si pasojë ka pasur një rënie të akteve normative nga njesite e veteqeverisjes vendore

Ka vazhduar asistimi me ndihmë juridike në mënyrë qoftë verbalisht apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e drejtë të tij.

### **Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të miratuara nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore është bërë, duke u përqendruar:**

●Buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, vendime në të cilat duhet të përcaktohet qartë dhe gjithmonë, qëllimi dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor.

● Përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës vetëm për raste të paparashikuara në buxhet dhe në përputhje me:

- parimin e përdorimit ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve publike,  
- me kriteret e përcaktuara në ligjin "Për emergjencat civile" dhe VKM Nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",

- Përdorimi i Fondit të kontigjencës sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave,

● Zbatimit të VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave" dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve". Sektori juridik edhe gjatë vitit 2016 ka pasur raste të trajtimit me VKB për miratim përdoruesish faktik të tokës bujqësore sipas VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 duke vazhduar të jetë rigoroz në respektimin e kriterëve ligjore

(miratimi i përdoruesve faktik vetëm me vendim të këshillit komunal, trajtimi sipas normës të tokës bujqësore, në m2, për frymë, sipas fshatrave, më 1.8.1991, për ish- kooperativat bujqësore referuar çertifikatës të frymëve të gjendjes civile në datën 1.8.1991, kjo mbështetur në ligjin Nr.7501 datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe Vendimit Nr.255 datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”,

- Një element kyç i këtij procesi ka qenë mbajtja e një regjistri të veçantë për secilin fshat, për regjistrimin e AMTP-ve që NJQV lëshonte, me të dhënat sipas lidhjes 2 bashkëlidhur VKM-së nr.253 & nr.222 dt 6.03.2013. Regjistrat e përgatitur nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore, i dërgohen prefektit të qarkut, i cili nënshkruan e vulos të gjitha fletët, bashkë me kopertinën. Pas nënshkrimit të regjistrat hartohet procesverbali nga Kryetari i bashkisë dhe prefekti procesverbal në të cilin pasqyrohet se sa regjistra dhe nga sa fletë u nënshkruan. Procesverbali mbahet në dy kopje, të cilat ruhen një në komunë/bashki dhe një në prefekturë. Regjistri i çdo fshati do të arkivohet së bashku me hartën përmbledhëse, ku janë të pasqyruara të dhënat për gjitha ngastrat e kaluara në pronësi.

- Prefekti me anë të shkresës nr.327/3 prot dt 28.4.2016 drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, ka informuar se asnjë NJQV nuk ka plotësuar AMTP bazuar te informacionet që kanë sjellë vetë NJQV, meqënëse asnjë regjistër nuk është depozituar te sekretari arkivi i Prefektit Qarkut Shkodër.

• Ka pasur shumë VKB për procedurat e zbatimit të VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në të cilat kemi konstatuar se nga administrata e NJQV nuk zbatoheshin afatet dhe procedurat që parashikon ky vendim.

• Riorganizimi i ujësjellësve ka qenë një sfidë për shkak se bashkitë duhej të riorganizoheshin sipas VKM Nr.63 dt.27.01.2016 “Për organizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, duke pakësuar apo shtuar kapitalin me vendim asambleje, gjë e cila solli vështirësi për NJQV. Bashkisë Shkodër, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe vendimet e para janë kthyer negativisht pasi riorganizimi nuk ishte bërë sipas ndarjes së re administrative. I është sqaruar bashkive se ato duhet të riorganizohen sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverisjes vendore në RSH” duke krijuar një operator të vetëm duke përfshirë të gjitha sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në zonën e juridiksionit, të gjitha njësitë administrative pjesë e sh.a fshat dhe operatorin ekonomik në bashkinë qendër. Nga operatori sh.a fshat duhet bërë zvogëlim të kapitalit me vendim asambleje, apo duke bërë transformim/shndërrim të ndërmarrjes sipas ligjit nr.9901/2007 “Për shoqëritë tregtare” neni 228 e në vijim (cilido qoftë statusi i tij juridik), kërkesë kjo edhe e shkresës së AKUK nr.2699 prot e datës 04.10.2016. I është theksuar se procesi duhej të mbështetet në dokumentacion ligjor, teknik dhe financiar sipas të dhënave kontabël që disponon secili operator me të gjitha detyrimet që kanë, duke mos cënuar procedurat e ligjit nr.9920 dt 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” (si procedurat e pezullimit të aktivitetit, lënien mënjantë të detyrimeve tatimore etj.)

- Për gjithë këtë proces është informuar Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime, Enti Rregullator të Ujit duke kërkuar edhe dhënie asistencë për NJQV.

• Risi për këtë vit ka qenë zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit.

#### **Nga verifikimi në vend i akteve është konstatuar**

- Bashkia Pukë, Malësi e Madhe nuk kanë bërë transferimin e dokumentacionit nga njësitë administrative të bashkia qendër, kërkesë e VKM nr.510 datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të

trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial nga NJQV. Bashkia Vau Dejës meqënëse ishte në proces rikonstruksioni, dokumentacioni ishte i pasistemuar.

- Është kërkuar pavlefshmëria në gjykatë për VKK Gjegjan (Nr.39 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës me fond prej 486 mijë lekë, Nr.40 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës në shumën prej 130 mijë lekë); VKK Rrape (Nr. 2 dt 25.02.2015 “Për përdorim të fondit rezervë në shumën prej 50 mijë lekë, për ndihmë emergjente djegie banese të z.Milel Zef Guga, fshati Rrape) , si NjA të bashkisë Pukë, vendime të cilat nuk janë depozituar në Institucionin e Prefektit për shqyrtim.

- Për eliminimin e shkeljeve nga verifikimet e ushtruara, në raportet e hartuara, janë lënë rekomandime/këshillime mbi kërkesat formale të aktit administrativ, shpalljen e akteve administrative, zbatimi i Kodit të ri të Procedurave Administrative ligjit nr.44/2015.

Janë ndjekur 4 procese gjyqësore, kryesisht me objekt kundërshtim dhe shfuqizim i aktit administrativ, vërtetim fakti për një çështje pensioni, konstatim diskriminimi por pala paditëse është tërhequr.

Nga verifikimi i Vendimeve për shpërndarjen e ndihmës ekonomike (mbështetet në Ligjin Nr. 9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Udhëzimit Nr. 338/3 dt 10.03.2006 “Për përcaktimin e kritereve, te procedurave dhe te masës se ndihmës ekonomike”, VKM Nr..787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike”), me ndryshime, Janë kthyer të gjitha VKB në rastet kur këshillat bashkiake kanë trajtuar familjet në një mase me te madhe se maksimumi i përcaktuar me ligj; I është kushtuar vëmendje që listat e familjeve përfituese duhet të jenë vetëm gra në përputhje me kriteret e çpercaktuara; I është bërë kujtesë, rekomandime për zbatimin e kritereve ligjore për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë në plotësimin e sakte të bazës ligjore ne vendim, në përcaktimin e datës së shpalljes dhe e hyrjes ne fuqi te VKB, në respektimin e kuotave te kompensimit te energjise elektrike dhe/apo kompensimit te telefonise fikse konform VKM nr. 404/2012 dhe VKM nr. 8/2015 si dhe udhezimeve respektive dhe i eshte kerkuar stafit administrativ te bashkive te behen ndalesat/shtesat perkatesisht; Jane ndjekur me vemendje hyrjet, daljet dhe riperfshirjet ne skemen e ndihmes ekonomike te familjeve ne nevoje dhe ne rastet kur jane konstatuar parregullsi është njoftuar menjëherë Drejtoria Rajonale e SHSSH, si struktura përgjegjëse për kontrollin në vend të dosjeve, me qëllim që trajtimi me ndihmë ekonomike të behet vetëm për ato familje që plotësojnë realisht kriteret ligjore.

### **VI.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor**

Nga ana e Institucionit të Prefektit është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organe të tyre.

Njësitë të vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjore (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve nga bashkia M.Madhe, Vau i Dejës, Pukë e Fushë Arëz; U është rikujtuar detyrimi i përcaktuar në aktin nënligjor, për marrjen e Vendimeve, të trajtimit të familjeve me ndihme ekonomike, brenda muajit; U eshte rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe

ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë konceptuar shkresa, me sqarime, mbi zgjedhjen e kryetarëve të rinj të fshatrave, sipas ndarjes së re territoriale ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të NJQV në RSH” duke i kërkuar marrjen e masave për organizimin e zgjedhjeve dhe të mos mjaftohen me zbatimin e nenit 70 të ligjit nr.139/2015 ( Vendimet për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, duke qenë vendime jo me karakter normativ, Prefekti vihet në dijeni pas zhvillimit të procedurave ligjore).

Janë organizuar takime të shumta për mbarëvajtjen e sezonit turistik; Përballimin e situatave emergjente; Sistemin e adresave dhe përditësimin e tij; Vlerësimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore; Riorganizimin e ujësjellësve, mbështetur në VKM Nr.63 dt.27.01.2016 “Për organizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”; Përdorimin e transfertës vetëm në shërbim të kryerjes së funksioneve të cilat u janë kaluar; Zgjidhjen e konflikteve me institucionet qendrore në nivel vendor; etj.

## **VII. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE**

### **VII.1. Verifikimi i titujve të pronësisë mbi token bujqësore**

Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut, ka ushtruar aktivitetin e tij në përmbushje me bazën ligjore dhe nënligjore, rekomandimet e Sekretariatit Teknik dhe detyrimet që pasojnë në funksion të zbatimit të ligjit Nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, VKM Nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përberjen, mënyren e funksionimit dhe detyrat e përgjegjesite e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, i ndryshuar, Kodi i procedurave administrative, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nga KV – të kur këtë e kërkojnë individë apo institucione”, Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e krijimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish NB – ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Vendore” miratuar me Vendimin Nr. 1 të Komisionit Qeveritar të Tokës dt. 27.03.2009 si dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatim të ligjit, që janë, VKM Nr. 604, datë 05.09.2012, VKM Nr. 605, datë 05.09.2012 “Për procedurat e njoftimit dhe mënyren e pagesës së detyrimit financiar në rastet e pavlefshmërisë së pjesshme të AMTP-ve, si rezultat i mosrespektimit të normës për frymë të tokës bujqësore”.

Në kuadrin e kontrolleve direkte të ushtruara nga Komisioni Vendor, për Vitin 2016, në bazë të Udhëzimit nr. 1, datë dt. 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të ish NB dhe zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, në bazë të të cilit, KV ka ushtruar kontrollet direkte me objekt verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të AMTP – ve të plotësuar në tokat bujqësore të ish Ndermarrjeve Bujqësore të Qarkut Shkodër. Gjatë këtij viti, është ushtruar kontroll direkt në këto fshatra: Në fshatin Grudë e Re, Shtoj i Ri, Njësia Administrative Rrethina, pjesë e ish Ndërmarrjes Bujqësore “Perlat Rexhepi”, Fshatrat Bërdicë e Sipërme, Bërdicë e Mesme, Njësia Administrative Bërdicë, pjesë e ish NB “Bërdicë”, fshati Rranxa, Njësia Administrative Bushat pjesë e ish NB Bushat.

Gjatë këtij viti janë trajtuar me përgjigje administrative 101 kërkesa. Kërkuesit i janë bërë të ditur Juridiksioni dhe kompetenca e Komisionit Vendor dhe janë orijentuar drejt institucionit që ka kompetencën dhe juridiksionin në zgjidhjen e problemit.

Janë pezulluar rreth 68 dosje deri në momentin që organi i akuzës të shprehet në lidhje me këto AMTP pasi origjinalet nuk ndodhen në arkivat e Zyrave Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, Pukë apo Malësi e Madhe por janë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Janë pezulluar 25 dosje deri në çeljen e dëshmise se trashigimisë. Me ndryshimet që i janë bërë Kodit Civil, çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nuk bëhet më në gjykatë por para noterit.

Sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titullit të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, Komisioni Vendor, ka qënë i përjashtuar nga pagesa e tarifave për shërbimet gjyqësore, ndërsa me ndryshimet ligjore të mësipërme, çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore duhet të bëhet para noterit, sipas tarifave monetare të përcaktuara nga ligji.

Janë në proces verifikimi administrativ 249 dosje, dosje këto të iniciuara në bazë të kontrollit direkt apo në bazë të kërkesës nga individët.

Gjatë vitit 2016 Komisioni Vendor ka trajtuar me 45 vendime AMTP për shfuqizim të plotë/pjesëshëm dhe ka kaluar në favor të Shtetit/ Bashkisë 21.8 ha tokë. Këto vendime i janë vënë në dispozicion dhe Zyrave Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, Pukë e Malësi e Madhe. Bazuar në pikën 4 e 5 të VKM Nr. 1269, date 17.09.2008, me ndryshime, Komisioni vendor ka kryer detyrimin, duke paraqitur ne Agjensine e Trajtimit të Prones të gjitha vendimet gjyqësore perfundimtare, të shoqeruara me planvendosjet e ngastres dhe procesverbalet përkatëse.

Janë dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër gjatë vitit, 45 kërkesë padi me objekt shfuqizimin e plotë apo të pjesëshëm të AMTP – ve.

Janë zhvilluar 203 seanca gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, përfshirë këtu jo vetëm 45 vendimet e marra në vitin 2016 por edhe vendimet e marra nga KV Shkodër gjatë viteve të mëparshme, të mbartura nga viti në vit në gjykim.

Çështjet për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, paraqiten:

<b>Çështjet gjyqësore të përfunduara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër gjatë vitit 2016</b>					
Nr.	Pranuar	Rrëzuar	Kthim Aktesh	Ankimuar	Pranuar/Formë e Prerë
1	12	19	1	20	3

Problematike gjatë vitit ka qënë :

1. Mungesa e Kartelave të pasurive të paluajtshme për të gjitha pasurite e aktit, ose vetëm përdisa pasuri, duke bërë të pamundur identifikimin e plotë të pronës, në rastet kur bëhet fjale për shfuqizim të plotë, ose identifikimin e pjesëshëm në rastet kur behet fjale për shfuqizim të pjesëshëm.

2. Përgjigjet evazive të ZVRPP kur thuhet se:

- a) nuk ka të dhëna për këto pasuri, b) nuk identifikohen të dhëna në emër të personit,
- c) nuk ka kartela të hapura, duke krijuar probleme në trajtimin me vendim të këtyre rasteve.

Vonesat, kryesisht ZVRPP Shkodër në kthimin e përgjigjeve ka bërë që të zvaritet tej mase procedimi administrative. Në lidhje me këtë problem i janë bërë disa herë shkresa për dijeni

Zyrës Qëndrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe situata vazhdon të mbetet e njëjtë.

3. Problematikë tjetër janë rastet kur mbajtësi i titullit të pronësisë objekt verifikimi, rezulton i vdekur, dhe nga trashëgimtarët, nuk është çelur dëshmia e trashëgimisë ligjore, ose këta të fundit nuk paraqiten në komision fare pasi nuk paraqesin interes.

Me ndryshimet që i janë bërë Kodit Civil, çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nuk bëhet më në gjykatë por para noterit.

Sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titullit të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, Komisioni Vendor, ka qënë i përjashtuar nga pagesa e tarifave për shërbimet gjyqësore, ndërsa me ndryshimet ligjore të mësipërme, çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore duhet të bëhet para noterit, sipas tarifave monetare të përcaktuara nga ligji.

4. Mos legjitimimi nga ana e Noterëve të Dhomës së Noterisë Shkodër të Institucionit të Prefektit të Qarkut të Shkodrës në çeljen e dëshmive të trashëgimisë për mbajtësit e titujve të pronësisë apo të familjarëve të AMTP të plotësuar plotësisht apo pjesërisht në kundërshtim me ligjin.

5. Adresat e personave, mbajtës të këtyre titujsh pronësie, janë të pasakta, ose personat janë larguar nga vendbanimet e mëparshme dhe Njësitë ose kryetaret e fshatrave nuk saktësojnë adresat aktuale. Ka raste kur personi nuk mund të njoftohet as për fillimin e procedimit dhe as për vendimin.

## VII.2. Shërbimet sociale

Verifikimi i ligjshmërisë së vendimeve të këshillave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, për shpërndarjen e ndihmës ekonomike, mbështetet në Ligjin Nr. 9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike”, me ndryshime, Udhëzimit Nr. 338/3 dt 10.03.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, te procedurave dhe te masës së ndihmës ekonomike”, gjatë të cilit janë kthyer të gjitha vendimet në rastet kur janë trajtuar familjet në një mase me te madhe se maksimumi i përcaktuar me ligj; I është kushtuar vëmendje që listat e familjeve përfituese duhet të jenë vetëm gra në përputhje me kriteret e VKM nr.376 dt 11.6.2014 për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike”; I është bërë kujtesë, rekomandime për zbatimin e kriterëve ligjore për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë në plotësimin e sakte të bazës ligjore ne vendim, në përcaktimin e datës së shpalljes dhe e hyrjes ne fuqi te VKB, në respektimin e kuotave te kompensimit te energjise elektrike dhe/apo kompensimit te telefonise fikse konform VKM nr. 404/2012 dhe VKM nr. 8/2015 si dhe udhëzimeve respektive dhe i eshte kerkuar stafit administrativ te bashkive (dhe komunave ish-njese te qeverisjes vendore) te behen ndalesat/shtesat perkatesisht; Eshte terhequr vemendja strukturave pergjegjese per mosmarrjen e VKB brenda muajit siç përcaktohet nga akti nënligjor; Jane ndjekur me vemendje hyrjet, daljet dhe riperfshirjet ne skemen e ndihmes ekonomike te familjeve ne nevojë dhe ne rastet kur jane konstatuar parregullsi është njoftuar menjëherë struktura përgjegjëse Shërbimi Social, Drejtoria Rajonale Shkoder, si struktura përgjegjëse për kontrollin në vend të dosjeve, me qëllim që minimumi jetik ti jepet vetëm familjeve që plotësojnë realisht kriteret ligjore. (rasti i NjA Kelmend për të cilën vetë Shërbimi Social-- Drejtoria e Përgjithshme inicioi një kontroll specifik për familjet përfituese pasi kishte familje të cilat pretendonin se trajtoheshin me ndihmë ekonomike edhe pse nuk ishin të pajisur me AMTP, rasti i bashkisë Vau Dejës për njësinë administrative Temal, (arsyeja eshte se ishin larguar nga skema e ndihmës ekonomike një numër i madh familjesh dhe ishte kërkuar rifutja përsëri muajin tjetër). Ne kuader te



konsulences ligjore ne lidhje respektimin e anes formale sa i takon dhenies se ndihmes ekonomike, pageses per paaftesi dhe invaliditet te punes janë pajisur me "broshuara informuese" administratorët shoqëror.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë kryer 31 inspektive, nga 33 të planifikuara (Nuk është kryer NjA Shosh, pasi nuk është përgjigjur njësia, si dhe NjA Qelëz, pasi është inspektuar nga shërbimi social shtetëror Tiranë), sipas të cilave janë konstatuar pagesa të tepërta të ndihmës ekonomike me vlerë 2,044 mijë lekë, për 395 familje; Janë trajtuar padrejtësisht me ndihmë ekonomike 696 familje në shumën 7,936 mijë lekë, të cilat me rekomandimin e lënë janë larguar nga skema; Kanë përfituar, pagesa të tepërta paaftësie 237 persona me vlerë 9,361 mijë lekë; Janë larguar nga skema e PAK nga komisionimet dhe rikomisionimet nga 524 persona.

### **VII.3. Zhvillimi i territorit**

Për ndjekjen e problemeve dhe zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur problem te ndryshme të territorit si strehimi, pronësie dhe mjedisi. Pjesa më e madhe e problemeve kanë qënë probleme në lidhje disancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës dhe lartësinë e ndërtesës, moszbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, , shqyrtimi i ndërtimeve paleje, shtesat anësore dhe në lartësi , në lidhje me pagesën e kështëve për shlyrjen për pëfitimin e programeve sociale të strehimit dhe pobleme me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse nga aktiviteteteve tregtare. Në kuadër të hartimit të plant të përgjithshëm kombëtar dhe planit të pëgjithshëm të bregdetit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë dërguar sygjerimeve dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe arritjen e një planifikimi.

Është bërë konfirmimi i gen planeve të objekteve që privatizohen apo jepen me qera, objekte këto që ndodhen ne Njesite Administrative Këlmend, Shalë dhe ne zonat e Pukës. Është bashkëpunuar me agjensinë e Basenit Drin-Bunë për të gjitha problemet që janë paraqitur duke bërë verifikimin e problemeve sipas rasteve të paraqitura.

Jane ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara per hartimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Vau-Dejës, veprimtari e cila konsiston ne pjesmarrjen ne disa dëgjesa publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër, për hartimin e planit të përgjithshëm vendor; Në shqyrtimin dhe bashkërendimin e punës në të gjitha hapat që do të ndërmerren për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe dhënjen e sygjerimeve konformë ligjit Nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zvvillimin e teritorit’.

### **VII.4. Zhvillimi i turizmit**

Megjithë problemet e hasura, viti 2016 për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e turizmit ka qenë më i mire gjatë viteve të fundit, çka shihet në shtimin e numrit të turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qendruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë shtimin e të ardhurave nga turizmi. Në përmirësimin e kryerjes së shërbimit të turizmit ka ndikuar kryerja e detyrave të ngarkuara nga të gjitha institucionit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, keshtu është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendra shëndetësore me personelim e duhur, por duke qendruar në gadishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike. Nga ana e Autoritetit Kombëtar të rrugëve janë kryer rikonstruksione të rrugëve (vlen të veçohet ndyrhyrja dhe rikonstruksioni i rruges Harku i Berdicës-Velipojë), si dhe mirëmbajtja e të gjitha akseve rrugore me destinacion turzmin. Janë marrë masat nga ana e policisë së shtetit për sigurinë publike në zonat turistike, si dhe nga policia e qarkullimit rrugor për parandalimin e aksidenteve gjatë sezonit. Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të

shpejtë në levizjen e shetasve të huaj e shqiptar (hyerje e dalje) në pikat kufitare (Hani i Hotit dhe Muriqan). Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer detyrimet në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit. Nga ana e Drejtorisë Rajonale AKU Shkodër janë inspektuar gjithsej 181 Operatorë të Biznesit Ushqimore, janë marrë 2 masa administrative “gjobë” me vlerë 40000 lekë si dhe janë marrë 66 masa administrative “Paralajmërimë”.

Nga ana e shërbimeve të policisë kufitare gjatë sezonit turistik është bërë në drejtim të menaxhimit dhe disiplinimit të mjeteve lundruese në plazhin e Velipojës dhe Shirok Zogaj, ku që në fillim të sezonit turistik në bashkëpunim me pushtetin Bashkinë Shkodër është bërë, përcaktimin e zonës ku motorrët e ujit lejohen të përdoren sipas përcaktimit të vijës së plazheve publike dhe/ose private të vëna në dispozicion nga Bashkia, oraret e përdorimit të mjeteve ujore, vendosjen e shenjave dalluese për të përcaktuar zonat deri ku lejohen të shfrytëzohen për plazh nga pushuesit, korridoret e hyrje/daljes dhe qarkullimit të motorrave të ujit. Janë planizuar me shërbim 3 mjete lundruese, prej të cilave 2 në plazhin e Velipojës dhe 1 në plazhet Shirok Zogaj.

Gjatë sezonit turistik nga ana e shërbimeve të policisë kufitare në plazhin e Velipojës, Shirok Zogaj u është dhënë ndihmë pushuesve në 83 raste me 127 shtetas, janë vendosur 21 masa administrative Gjoba me vlerë 233 mijë lekë dhe janë bllokuar administrativisht 3 mjete lundruese (motorr uji)

Nga ana e Drejtorisë së Autoritetit Verior të Rrugëve janë marrë masat e domosdoshme për mirëmbajtjen e të gjitha akseve rrugore turistike të Qarkut të Shkodrës, nepermjet kontraktorëve të mirëmbajtjes, pasi për investime nuk janë programuar fonde. Është riparuar, duke asfaltuar një sip. prej 7500 m<sup>2</sup>, në segmentin Harku i Berdices-Velipojë, në një gjatësi 13 km, në pjesën nga Harku i Berdicës. Në bashkëpunim me Policinë Rrugore janë vendosur rreth 300 tabela në vendet me të domosdoshme dhe që përbënin shkak për aksidente. Në segmentin rrugor Harku i Berdicës-Velipojë bërë vizimi i mesit të rrugës Gjithashtu në Aksin Koplik – Boge – Razem është bërë kompletimi me tabela dhe mbyllja e gropave në asfalt. Si rezultat i masave të marra gjatë gjithë sezonit nuk ka patur probleme në akset rrugore

Nga ana e Operatorit të shpërndarjes energjisë elektrike, si rezultat i masave të marra (investime e mirëmbajtje në rrjetin e t/u, në nënstacion e kabina elektrike) është bërë furnizim pa ndërprerje me energji elektrike gjatë gjithë sezonit. Po kështu janë marrë masa për furnizimin normal të pushuesve me ujë të pijshëm.

Po kështu është përmirësuar puna e njërive të vetëqeverisjes vendore në drejtim të mbarvajtjes së turizmit.

Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër, nëpërmjet stafit të saj si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore ka marrë të gjitha masat e nevojshme që për të gjithë monumentet e kulturës të cilët janë të vizitueshëm të ketë tabela informuese, me qëllim promovimin sa më të mirë të pasurive të shumta të trashëgimisë kulturore që posedon qyteti jonë, gjithashtu në kuadër të disa projekteve është bërë i mundur aksesimi për në disa objekte ku më parë ka qënë i pamundur të vizitoheshin për shkak të bimësisë dhe mungesës së rrugëve, janë marrë të gjitha masat që objektet e vizitueshme të pastrohen nga mbetjet e mbeturinave nga punonjësit e DRKK në bazë ditore

Në kuadër të bashkëpunimit ndërstitucional, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AdZM (Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura), me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit dhe marketingun e destinacionit ka ngritur zyrën e informacionit turistik në njësinë administrative Velipojë dhe në Theth

Gjatë sezonit veror nga ana e bashkisë Shkodër është bërë një punë më e mirë krahasuar me vitet e kaluara në menaxhimin e territorit dhe të hapësirave publike në territorin e plazhit të Velipojës. Është bërë promovimi i destinacioneve, ofertave turistike nëpërmjet organizimit të panairëve dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe të argëtimit.

Bashkia Shkodër që në fillim të vitit ka bërë një vleresim të gjendjes së infrastruktures së qendrave shëndetësore në zonat turistike me frekuentim të shtuar të pushuesve. Për përballimi e kësaj situatë Bashkia e Shkodrës ofroj hapësirë e nevojshme nga ambientet e saja për ta përdorur shërbimi shëndetësorë në plazhin e Velipojës duke siguruar kështu shërbimin e nevojshëm për komunitetin. Njëkohësisht në bashkëpunim me Fondacionin Vodafone Albania dhe Bashkisë Shkodër u bë i mundur financimi për riparimin e qendrën shëndetësore Theth.

Nga ana e bashkisë Shkodër janë marrë masat për përmirësimin e performancës së shërbimit të pastrimit në zonat turistike.

Si rezultat i bashkëpunimit në mes të të gjithë aktorëve për një ambient më të pastër, i gjithë territori i zonave turistike ka qenë më i pastër krahasuar me vitet e tjera.

Qyteti i Shkodrës ka pritur vizitorë të shumtë (në monumentet e trashëgimisë kulturore; Muzeu Kombëtar i fotografisë “Marubi” dhe destinacione të tjera). Gjatë sezonit turistik veror numri i personave në stacionin e plazhit Velipojë ka qenë i lartë ( mesatarisht rreth 50 000 persona në muaj). Nga pikat kufitare gjatë sezonit turistik kanë hyrë dhe dale 989549 shtetas dhe 352076 mjete, me një rritje prej 20 % krahasuar me sezonin e kaluar.

Po kështu edhe me destinacion turizmin malor-alpet e Shqipërisë (Razem, Theth Boge), si dhe Pukë e F.Arëz numri i turistëve të akomoduar ka qenë e lartë dhe me rritje nga viti i kaluar.

Gjatë vitit kanë hyrë e dalë 2, 568, 255 shtetas dhe 962, 964 mjete, krahasuar me vitin e kaluar 180, 397 shtetas me shume ose rreth 7% dhe 114962 mjete me shume ose 12% (vetëm gjatë sezonit veror kanë hyrë dhe dale 989549 shtetas dhe 352076 mjete, me një rritje prej 20 % krahasuar me sezonin e kaluar veror).

Bashkëpunimi i njëjësive të vetëqeverisjes vendore me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë ka qenë i mirë, nepermjet Qendres Shëndetësore te Plazhit është ofruar shërbim shëndetësor 24 orësh, për pushuesit (Ka patur 19 raste të rrezikimit për mbytje të turistëve dhe të gjitha rastet janë shpëtuar nga ana e këtij shërbimi; 8 raste janë dërguar në Shkodër për ndihmë më të specializuar). Është viti i parë që në plazhin e Velipojës nuk ka patur asnjë humbje jete, si rezultat i këtij bashkëpunimi.

Bashkëpunimi me struktura e policisë vendore ka qenë në nivele shumë të mira (Policia e Shtetit ka bashkëpunuar në lidhje me mbajtjen e rendit dhe të qetësisë në Njësine Administrative Velipoje, ku si rezultat i këtij bashkëpunimi nuk është shënuar asnjë rast vjedhje apo raste të tjera të shkeljes së ligjit; Policia ka bashkëpunuar në mbajtjen e qetësisë në të gjitha organizimet kulturore sportive të organizuara nga ana e njëjësive të vetëqeverisjes vendore). Po kështu edhe me Policinë Kufitare dhe Migracionit bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë, I gjithë fluksi i qarkullimit të shtetasve dhe mjeteve (hyrje e dalje) në pikat kufitare është përballuar, pa krijuar rradhe të gjata apo shqetësime tek qytetaret (Gjatë sezonit turistik veror për shkak të fluksit të madh në PKK-Muriqan dhe Hani i Hotit me qëllim moskrijimin e rradheve të gjata si në hyrje ashtu dhe në dalje është punuar me procedura të lehtësuara); Janë percaktuar tre vende të rrugëve detare për motorrat e ujit. Të gjitha vendet e tjera janë quajtur të paligjshme nga Policia Kufitare dhe janë ndaluar të gjitha skafet e motorrat e ujit që kanë lundruar apo janë parkuar jashtë ketyre destinacioneve të percaktuara (Si rezultat i bashkëpunimit nuk ka patur asnjë ngjarje të rëndë gjatë sezonit, nga veprimtaria motorëve). Në nivele të kënaqëshme ka qenë bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit.

Problematikat e hasura gjatë këtij sezoni dhe koordinimi me aktorët e tjerë publik për sa i përket garantimit të sigurisë fizike të pushuesve, cilësinë e shërbimit, shëndetit publik , higjienës etj. të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në mbarvajtjen e turizmit:

- Klasifikimi i strukturave akomoduese dhe çertifikimi i tyre, sipas sipermarrjeve turistike.

- Mungesa e udhërrëfyesve turistik të çertifikuar.

- Në stacionet e plazhit nuk janë zbatuar kriteret e standardet e përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së plazhit” (miratuar në VKM 369 datë 18.05.2016) lidhur me vendosjen e kullave të vrojtimit me vrojtues gjatë gjithë orarit të plazhit (neni 6/3.ç i rregullores) si dhe Moslejimin e shitësve ambulantë nga subjektet të cilat zhvillojnë veprimtari në hapësirat e marra me qera sipas kontratës (neni 5/6 i rregullores), duke ndikuar negativisht në imazhin e turistëve

-Rikonstruksioni sipas parametrave bashkohor të rruges që lidh Harkun e Berdices me Plazhin e Velipojes (Në mënyrë të veçantë, si nevojë e domosdoshme rregullimi dhe zgjidhja e përhershme e trafikut tek harku i Berdicës, me anën e një mbikalimi), si dhe akseve rrugore të Njesive Administrative të zones malore të Dukagjinit

- Bashkëpunimi në mes bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve dhe Hetimit Tatimor nuk ka qenë i mirë, kryesisht në ushtrimin e kompetencave ligjore për subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje në plazhin Velipojë (kanë ushtruar aktivitet të paligjshëm 60 subjekte, hotele e aktivitet të ndryshëm tregtar), si dhe zaptimin e parcelave të plazhit nga ana e subjekteve të paligjshme (gjatë sezonit janë zaptuar 60 parcela), me ndikim edhe në uljen e të ardhurave në Bashkinë Shkodër

- Një bashkëpunim jo i mirë ka qenë në mes bashkisë Shkodër dhe Ujësjellës Kanalizime Fshat, kjo në trajtimin dhe largimin e ujrave të ndotura

#### **VII.5. Shërbimi i gjendjes civile**

Zyra e Gjendjes Civile (arkivi) ka mbledhur, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentacionin që administron vetë zyra, duke u bazuar në rregjistrat themeltarë si dhe në akte, me kërkesën e qytetarëve të interesuar apo institucioneve të ndryshme, fluksi i të cilave përveç nevojave të ndryshme është edhe në varësi fazave të procesit të kompensimit të ish-pronareve e ish të përndjekurve politik, legalizimit

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësive administrative pjesë përbërëse e këtyre bashkive, duke bërë verifikimet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme si Prokuroria, Gjykata, Sigurimet Shoqërore, Drejtoria e Policisë apo Zyra Konsullore.

Janë marrë masa që korrigjimet e adresave të kryhen menjëherë dhe në mënyrë korrekte nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile

Ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore”Për gjendjen Civile” u janë bërë të njohura zyrave të gjendjes civile brenda qarkut.

## VIII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS

### VIII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër*"), si dhe e Komisionit vendor të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore, sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave (VKM Nr. 1269 date 17.09.2008 "*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore*", me ndryshime), me një organikë prej 33 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi e Madhe dhe Pukë)	2
4.	Spektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
5.	Spektori i zhvillimit urban	3
6.	Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	3
7.	Spektori juridik	3
8.	Spektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	7
9.	Komisioni vendor i vlersimit të titujve të pronësisë	6

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 33,283 mijë lekë, ose 85.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim fondesh prej 5,713 mijë lekë. Ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 2,736 mijë lekë, ose 99.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 23 mijë lekë. Programimi dhe përdorimi i fondeve, sipas programeve, në nivel art. Paraqitet, sipas pasqyrës:

Art.	N/Art.	Emertimi i shpenzimeve	Programimi dhe përdorimi				
			Plan 2016	Ndrysh.	Plani me ndryshime	Fakti	Dif.
<i>Administrita e Institucionit (Gr.16, T 1160, Kap. 1)</i>							
<b>600</b>		<b>PAGA, SHPERBLIME DHE TE TJERA SHPENZ. PERSONELI</b>	<b>26,300</b>	<b>1,727</b>	<b>24,573</b>	<b>22,053</b>	<b>2,520</b>
<b>601</b>		<b>KONTRIBUTI PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE</b>	<b>4,420</b>	<b>-</b>	<b>4,420</b>	<b>3,651</b>	<b>769</b>
<b>602</b>		<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	<b>6,450</b>	<b>3,470</b>	<b>9,920</b>	<b>7,496</b>	<b>2,424</b>
	<b>602,01</b>	<b>Materiale dhe sherbime zyre te pergjithshme</b>	<b>785</b>	<b>223</b>	<b>1,008</b>	<b>672</b>	<b>336</b>
	0100	Kancelari e tjera	400	-	400	281	119
	0200	Mat. për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim	100		100	61	39
	0300	Materiale për funksionimin e zyreve	200	223	423	322	101
	0500	Blerje dokumentacioni	15	-	15	8	7
	0900	Furnizim dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme	70	-	70		70
	<b>602.2</b>	<b>Sherbime nga te tretet</b>	<b>1,190</b>	<b>150</b>	<b>1,840</b>	<b>1,306</b>	<b>534</b>
	2001	Elektricitet	700	-	700	488	212
	2002	Uje	70	-	70	73	(3)
	2003	Sherbime telefonike:	470	100	370	143	227
		<i>Fikse</i>	<i>350</i>	<i>100</i>	<i>250</i>	<i>143</i>	<i>107</i>
		<i>Celulari</i>	<i>120</i>	<i>-</i>	<i>120</i>	<i>-</i>	<i>120</i>
	2004	Sherbime te tjera (Posta)	500	100	600	574	26
	2010	Sherbime të printimit dhe publikimit	250	150	100	27	73
	<b>6023</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>1,113</b>	<b>123</b>	<b>990</b>	<b>765</b>	<b>225</b>
	3100	Karburanti	700		700	675	25
	3100	Karburanti 20% nga viti 2014	123	123	-		-
	3200	Pjese kembimi ,goma dhe bateri	150		150	15	135
	3300	Rregjistrim,kalaudim ,siguracion	70		70	29	41
	3900	Te tjera	70		70	46	24
	<b>6024</b>	<b>Shpenzime udhëtimi</b>	<b>250</b>	<b>-</b>	<b>250</b>	<b>67</b>	<b>183</b>
	4100	Udhëtim I brendshëm	250		250	67	183
	<b>6025</b>	<b>Shpenzime per mirmbajtje te zakonshme</b>	<b>500</b>	<b>50</b>	<b>550</b>	<b>258</b>	<b>292</b>

	5600	Shpenzime per mirmbajtjen e mjeteve te tansportit	150		150	122	28
	5800	Shpenzime per mirmbajtjen e paisjeve te zyreve	150	50	200	136	64
	5300	Shpenzime per mirmbajtjen e objekteve ndertimore	200	-	200	-	200
	<b>6027</b>	<b>Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale</b>	<b>1,462</b>	<b>3,470</b>	<b>4,932</b>	<b>4,236</b>	<b>696</b>
	602.74	Shpenzime per vendime gjyqsore për largim nga puna	1,462	3,470	4,932	4,236	696
	<b>602.9</b>	<b>Shpenzime te tjera operative</b>	<b>350</b>	<b>-</b>	<b>350</b>	<b>192</b>	<b>158</b>
	602.9	Shpenzime per pritje percjellje	50		50	27	23
	602.91	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime	200		200	127	73
	602.9	Shpenzime per tatime,taksa,rregjistrim pasurie nga institucioni etj.	100		100	38	62
	<b>606</b>	<b>Transferta per buxhete familjare dhe individe</b>	<b>-</b>	<b>83</b>	<b>83</b>	<b>83</b>	<b>-</b>
	<b>230</b>	<b>Shpenzime per rritje te A.Q. te patrupzuara</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>231</b>	<b>Shpenzime per rritjen e A.Q. Te trupzuara</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
		<b>Totali:</b>	<b>37,170</b>	<b>1,826</b>	<b>38,996</b>	<b>33,283</b>	<b>5,713</b>

*Gjendja Civile (Gr.16, T 1170, Kap. 1)*

<b>600</b>	<b>PAGA, SHPERBLIME DHE TE TJERA SHPENZ. PERSONELI</b>	<b>2,364</b>	<b>-</b>	<b>2,364</b>	<b>2,345</b>	<b>19</b>
<b>601</b>	<b>KONTRIBUTI PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE</b>	<b>395</b>	<b>-</b>	<b>395</b>	<b>391</b>	<b>4</b>
<b>602</b>	<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
		<b>2,759</b>	<b>-</b>	<b>2,759</b>	<b>2,736</b>	<b>23</b>

**VIII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre**

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga Prefekti janë nxjerrë 54 Urdhra, me problematika të ndyshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara

Administrata ka zbatuar në të gjitha raste urdhërat e nxjerrë duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

Është bërë konfirmimi i genplaneve në mbështetje dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të ministrave Nr. 926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”.

**VIII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë**

**Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit nr. 21 të ligjit nr. 8927 datë 25.7.2002 “Për prefektin” dhe nenit nr. 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”**

Është ngritur grupi këshillues pranë Prefektit, me Urdher në përputhje me nenin 23 të Ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, i përbërë nga 23 anëtar

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësive nga ana e Prefektit janë zhvilluar takime të shumta, të cilat në formë të përmbledhur, sipas çeshtjeve të trajtuara, paraqiten:

- Marrja e masave për përballimin e situatave të pritshme emergjente në qarkun e Shkodres. Si rezultat i rreshje të dendura të shiut në zonen e nënshkodres janë krijuar probleme të mëdha si pasoje e mosrrethjes për një kohë të gjatë në pastrimin e kanaleve kulluese si nga ana e Njesive të Qeverisjes Vendore ashtu edhe nga ana e bordit të kullimit Shkoder (date 6 Janar).

- Mbi masat që duhen marrë për parandalimin dhe shuarjen e zjarrjeve gjatë stinës së verës” marrjen e masave parandaluese dhe koordinimin e punës me prefektoren në kuader të ligjit të ri për PMNZSH-së (date 15 Qershor).

- Mbi menaxhimin nga ana e shtabit të emergjencave civile të situatave të përmblyetjeve të shkaktuara nga rreshjet e diteve të fundit dhe masat parandaluese në mënyrë që situatë të mbahet nënkontroll (takim date 7 e 8 Nëntor)

- Organizimi i grupeve vullnetare për rastet e fatkeqësive natyrore si në rasteve përmblyetjeve, termete, shkarje dheu etj. Takim date 11 Shkurt me një grup vullnetarësh nga mbrojtja civile italiane, për raste të emergjencave civile; me pjesëmarrjen edhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile. Prefekti propozon një alternativë tjetër nga ajo e Bankes Botërore për shmangjen e përmblyetjeve në Qarkun Shkoder.

- Mbi menaxhimin e situatave të përmblyetjeve dhe rolit të grupeve vullnetare në këto situata. Praktikë e ndjekura nga shteti i Italisë dhe që pritet të implementohet edhe në shtetin Shqiptar (date 3 Nëntor)

- Mbi masat që duhen marrë për menaxhimin e sezonit turistik (takim date 31 Maj në Velipojë, takim në të cilin prezantohet Urdhri i Prefektit “Për ngritjen e grupit të punës për menaxhimin e sezonit”, si dhe Plan i Masave “Për menaxhimin e sezonit” Nr. 393/2 Prot. date 24 Maj)

- Masat për zbatimin e projektit për sistemin e ri të adresave (takim me drejtues të MPB në Lezhë), si dhe me drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut Shkodër (date 16 Qershor). Procesi duhet të përfundojë Brenda datës 31 Dhjetor 2016.

- Likuidimin e detyrimit të mbetur si dëmshpërblim të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese nga rreshjet e shiut dhe përmblyetjeve (viti 2010-2011) në qarkun Shkodër, nëpërmjet shuarjes me kompensim të detyrimeve ndaj OSHEE. Prefekti i Qarkut Shkoder ka propozuar që detyrimet që këto banorë kanë ndaj OSHEE të zbriten nga detyrimet që vete OSHEE (KESH) ka ndaj banorëve që janë përmblytur në vitin 2010-2011 dhe nuk janë kompensuar në vlerën 100%. Nga të dhenat e përpunuara rezulton se këto banorë janë kompensuar në vlerën 49.7 % të vlerës së përcaktuar me VKM ( takim date 29 Janar dhe 2 Shkurt)

- Analizë vjetore e grupit të KRAT, në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve nënjëzore. Gjatë vitit 2015 ka patur një përmirsim të dukshëm të fenomenit të trafikimit të qenieve njëzore, shqetësuese mbeten rastet e kalimit të kufirit nga familjarët për vizita turistike apo kur kërkojnë azil politik në vendet e BE dhe kthehen pa femijet e mitur me dëshirën për të përfituar leje qëndrimi nga këto të fundit për shkak të moshës, në vendet e BE. Megjithatë këto janë raste sporadike dhe në të shumtën e rasteve janë zgjidhur me marrveshje me vendet e BE-së (date 5 Shkurt)

- Marrjen e masave për eliminimin e shitjes së duhanit të grirë në tregje informale, si dhe mbajtjen e transportimit pa pullë fiskale, pasi është mall i tatueshëm me akcizë (datë 16 Shkurt)

- Bashkëpunim në fushën arsimit mes Kosovës dhe Shqipërisë” duke u bazuar në kulturën e përbashkët të dy shteteve (date 29 Mars)



- Mbi funksionimin e zyrës së ankesave pranë Ministrisë së punëve të brendshme (date 1 Prill)

- Mbi procesin e ndarjes sipas kriterëve të ligjit 7501”, shtyrjes së afatit për plotësimin me tokë për subjektet që e posedojnë tokën por nuk janë të paisur me tituj pronësie. Procedura që do ndiqet në keto raste nga nashkitë e re dhe deri në rregjistrimin e tyre në ZVRPP (date 12 Prill) dhe propozime për ndryshime në ligj për të përfshirë si rast edhe ndarjen e tokës në fufijtë e vjeter, gjithmonë duke iu referuar tokave të cilat nuk janë ndarë sipas ligjit 7501 (takim date 22 Prill)

- Mbi çeshtjet e pronësisë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, ndryshimet që duhet të pasqyrohen në menyre që ky problem të gjej zgjidhje në here e përgjithmonë në Shqipëri (date 29 Qershor)

- Mbi ndryshimet ligjore për funksionimin e baseneve dhe përshtatja e tyre me ndryshimet që kanë sjell ndarja e re administrative –territoriale (date 25 Prill), si dhe konstituimi i këshillit të basenit Drin-Bunë me antarët e rinj, në përputhje me VKM, ku përfshihen anëtar nga të gjithë qytetet ku kalon Drini në republikën e shqipërisë (25 Maj).

- Mbi masat që duhen marrë ndaj shtimit të rasteve të kërkesave për azil politik-ekonomik dhe fenomenit të gjakmarrjes nga ana e shqiptarëve në shtetin Belg. Delegacioni Belg edhe një here i ben thirrje të gjithë shqiptare se duke qene se Shqipëria hyn në zonën e “vendeve të sigurta” kërkesat e tyre për azil do të refuzohen (date 14 Qershor)

- Mbi rekrutimin e të rinjve në strukturat e forcave të armatosura, kushtet që duhet të plotësohet, favorizimet për ata të cilët do të përzgjidhen dhe mundësitë për një karrierë në ushtri (date 13 Shtator).

- Mbi evidentimin e problemeve në kopshte e çerdhe (publike e private), në kuadrin e ngritjes dhe funksionimit të grupit ndërshtetëror të krjuar për keqë qellim (1 Nëntor)

- Takime të tjera, pritje ambasadorit Grek (10 Maj); Mbi miratimin e strukturave të re organizative në kuadrin e ristrukturimit të Institucionit; Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet; Mbi çeljen e trashigimisë, për efekt të procedimit administrativ; Mbi zbatimin e Urdhrit Ekzekutiv të Përmbaruesit Gjyqësor; etj.

#### **VIII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve**

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë vitit në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje 117 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, kërkesa dhe ankesa të ardhura direkt, ose nepermjet institucioneve të tjera qendrore, të cilat sipas problematikës paraqiten:

- Për Vendimet e Këshillave të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe të Kryetarëve të fshatrave 12
- Për çeshtjet e pronësisë dhe zënien e hapësirave publike 25
- Për mjedisin e menaxhimin e mbetjeve 7
- Për çeshtjet e punësimit 8
- Për dëmshpërblim dhe emergjencat 8
- Për shërbimin e furnizimit me energji elektrike (OSHEE) 3
- Për pagesën e Ndihmës ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit 8
- Për shërbimin Shëndetësor 1
- Për shërbimin e transportit 2
- Për masa administrative (falje gjoba) 8
- Të tjera 35

### **VIII.5. Veprimtaria e N/Prefektit**

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në neni 20 të Ligjit Nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin dhe nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e qarkut”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka bashkëpunuar me institucionet qendrore në nivel vendor, duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre institucioneve me bashkitë janë organizuar takime gjatë vitit për problemet e rendit, të turizmit, emergjencave, sistemit të adresave.

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre.

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe NjA pjesë perberëse e bashkive, si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve.

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

### **IX. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT**

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria vendore e policisë në 69 raste, duke marrë vendimet përkatëse

### **X. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2017 DHE DETYRAT PËR MBARVAJTJEN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE TË 18 QERSHORIT**

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, duke u përqendruar vëmendjen në:

1. Mbikqytja e punës dhe veprimtarisë në realizimin e programit qeverisës, duke kërkuar nga institucionet qendrore në nivel vendor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit

2. Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferikje, apo nga faktor të tjerë (Rishikimi i planeve dhe standartizimi me nivelet e planeve Europiane; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve

emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente)

3. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me institucionet qendrore në nivel vendor dhe bashkitë, për realizimin e detyrave sipas programit qeverisës

4. Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera për parandalimin e fenomeneve, që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën, parandalimin e veprave penale dhe sigurimin e rendit publik.

5. Bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave ligjore, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim

6. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore (*referuar parimeve të ligjshmërisë; Barazisë dhe proporcionalitetit; Mbrojtjes së interesit publik; Drejtësisë dhe paanësisë; Bashkëpunimit dhe të përgjegjshmërisë; Efiçiensës; Të sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit*), veçanërisht gjatë periudhës parazgjedhore, të akteve të cilat kanë të bëjnë me programimin dhe kryerjen e shpenzimeve, duke monitoruar me kujdes ashtu si shpenzimet edhe të ardhurat e realizuara (Duke qënë një vit në të cilin zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme dhe periudha parazgjedhore krijon mundësi keqadministrimi dhe shpërdorimi).

7. Bashkëpunimin me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe institucionet qendrore në nivel vendor për sensibilizimin e popullsisë për realizimin e nismës së ndërmarrë nga Mnistria e Punëve të Brendshme “*Shqipëria pa armë*”